

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES BANKARE
KORRIK 2004**

***MBIKËQYRJA BANKARE
RAPORTI VJETOR 2003***

***BANKING SUPERVISION
ANNUAL REPORT 2003***

**BANK SUPERVISION DEPARTMENT
BANK OF ALBANIA
JULY 2004**

Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr. I, Tiranë.

Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;

Faks : 355-4-223558

e-mail: public@bankofalbania.org

[http:// www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni Sektori i Publikimeve,

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi : 800 kopje

Published by : Bank of Albania, Sheshi “Skënderbej”, No. I, Tirana, Albania

Tel: 355 - 4 - 222152; 222153; 222156;

Fax: 355 - 4 - 223558

e-mail: public@bankofalbania.org

[http:// www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

For all the information concerning this publication please contact Publications Unit,

Public Relations Department

Printing by BoA Printing House

Printed in 800 copies

Përmbajtja

HYRJE 4

1.	MISIONI I MBIKËQYRJES BANKARE	5
2.	VEPRIMTARIA BANKARE DHE MBIKËQYRJA	8
2.1	Disa fjalë mbi ambientin ekonomik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Eurozonë dhe në Shqipëri.	8
2.2	Analiza e sistemit bankar	9
2.2.1.	Aktivitetet e sistemit bankar, struktura dhe cilësia e tyre.	9
2.2.2	Struktura e aktiveve.	11
2.2.3	Aktiviteti kreditues.	12
2.2.4	Cilësia e aktiveve	14
2.3	Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.	14
2.4	Efektiviteti	16
2.5	Mjaftueshmëria e kapitalit.	17
2.6	Likuiditeti	19
2.7	Mbikëqyrja në vend	20
2.8.	Ndryshimet dhe zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ	22
2.8.1	Rregullimet	22
2.8.2	Licencimi	24
3.	ZHVILLIME TË RËNDËSISHME	25
3.1	Privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe pritshmëria	25
3.2	Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit	28
3.3	Plani i Zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes	29
4.	ÇËSHTJE QË KËRKOJNË VËMENDJE TË VEÇANTË DHE KONKLUZIONE	31
5.	TË TJERA	34
5.1.	Akordi i ri i Bazelit, vlerësim paraprak.	34
6.	ANEKSE	37
6.1.	Aneks 1 : Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë	37
6.1.1	Banka dhe degë të bankave të huaja	37
	Subjekte jobanka	40
	Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: “Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë””.	42
	Zyra të këmbimeve valutore	43
	Unionet e shoqërive të kursim-kreditit	49
	Zyra të përfaqësimit të bankave të huaja	50
	Aneks 2: Lista e rregulloreve të mbikëqyrjes bankare në fuqi, deri në muajin korrik 2004	51

I. HYRJE

I nderuar lexues,

Departamenti i Mbikëqyrjes, si pjesë integrale e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2003 ka synuar në përbushjen e misionit të tij, atë të monitoruesit të ecurisë së sistemit bankar dhe më gjerë, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.

Viti që lamë pas, shënoi zhvillime strukturore dhe institucionale të departamentit të cilat patën ndikimin e tyre pozitiv në drejtim të përmirësimit të rrjedhshmërisë së informacionit, të komunikimit brenda dhe jashtë departamentit, të rritjes së shkallës së profesionalizmit dhe etikës në procesin e punës, të përmirësimit të aftësive monitoruese dhe analizuuese në vend dhe në distancë, të zgjerimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator si edhe në tërësi, rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse.

Ne jemi të kënaqur që viti i kaluar shënoi zhvillime sasiore dhe cilësore për industrinë bankare në vend. Nëpërmjet rritjes së pranisë në rajone të ndryshme të vendit, ofrimit të një spektri më të gjerë produktesh bankare dhe një rentabiliteti të kënaqshëm, sistemi bankar është aktualisht më pranë publikut. Këto zhvillime pozitive, para së gjithash janë fryt i një angazhimi serioz të sistemit bankar shqiptar për të luajtur një rol më të fuqishëm në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të ekonomisë shqiptare në tërësi.

Ne besojmë se edhe mbikëqyrja ka patur dhe ka një rol të rëndësishëm në këto zhvillime, duke u kujdesur për paralajmërimin në kohë të situatave dhe të tendencave të padëshirueshme në sistemin bankar, si edhe për nxitjen e bankave për të implementuar sistemet e nevojshme të identifikimit dhe të monitorimit të transaksioneve që mbartin rrezik të qenësishëm në aktivitetin e përditshëm, me qëllim mbarëvajtjen sa më të mirë të sistemit bankar. Vendosja dhe ruajtja e një ekuilibri midis qëllimit të biznesit bankar për të rritur fitimet dhe nevojës për të njohur dhe administruar rrezikun që sipërmerret në aktivitetin, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e punës tonë.

Ne besojmë se strukturat drejtuese të bankave, duke përfshirë këshillin drejtues dhe komitetin e kontrollit, janë tashmë të vetëdijshme për rëndësinë që ka angazhimi i tyre dhe përgjegjësinë që ata kanë në plotësimin e kuadrit të politikave dhe të procedurave, si edhe në monitorimin nga afër dhe në mënyrë të vazhdueshme të ecurisë së bankës, me qëllim kryerjen e aktivitetit të përditshëm të saj në mënyrë të sigurtë. Strukturat drejtuese në banka, duhet ta vendosin theksin e punës së tyre në drejtim të identifikimit, të matjes dhe të administrimit të rrezikut që bankat sipërmarrin gjatë aktivitetit, për të shmangur vështirësitë financiare dhe humbjet e papritura.

Së fundi, me privatizimin e Bankës së Kursimeve, sistemi bankar në Shqipëri ka hyrë në një fazë të re zhvillimi, shumë më të shpejtë. Banka e Shqipërisë dhe Departamenti i Mbikëqyrjes, synojnë t'iu përgjigjen në kohë këtyre ndryshimeve, për t'i paraprirë zhvillimeve të mundshme të padëshiruara. Përfitoj nga rasti të konfirmoj angazhimin tonë në këtë drejtim, si edhe të ftoj industrinë bankare në vendosjen e një dialogu të qëndrueshëm dhe produktiv me synimin e përmirësimit cilësor të marrëdhënieve midis institucioneve tona në fushën e mbikëqyrjes. Ftoj publikun e gjerë, të rrisë vëmendjen e tij ndaj zhvillimeve në sistemin bankar, ku kemi investuar fondet dhe kursimet tona. Në këtë mënyrë, pocesi i administrimit të aktivitetit bankar do të ishte më transparent dhe përgjegjshmëria e aktorëve në sistemin bankar do të ishte shumë më e madhe. Duke shprehur besimin për një vit të ri të mbarë në ecurinë e aktivitetit bankar, ju falenderoj për vëmendjen.

Klodion Shehu
Drejtor
Departamenti i Mbikëqyrjes

I. MISIONI I MBIKËQYRJES BANKARE

Funksioni i mbikëqyrjes bankare ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” nr. 8269, datë 23.12.1997 dhe ligjit “ Për bankat në Republikën e Shqipërisë” nr. 8365, datë 02.07.1998.

Misioni i Mbikëqyrjes bankare është ushtrimi i një mbikëqyrjeje të kujdesshme, të vazhdueshme dhe në mënyrë të pavarur, ndaj të gjitha institucioneve financiare të licencuara prej Bankës së Shqipërisë, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e biznesit të tyre. Mbikëqyrja bankare ka një rol identifikues dhe parandalues të problemeve që mund të shfaqen në institucionet që licencohen nga Banka e Shqipërisë, në mënyrë që, në varësi të institucioneve që preken, këto probleme të mos shndërrohen në një kërcënim potencial për qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar. Nëse kjo do të ndodhte, përveç të tjerash, do të çenohej imazhi dhe reputacioni publik i këtyre institucioneve dhe i Bankës së Shqipërisë, me pasoja negative për shëndetin dhe rritjen në tërësi të ekonomisë shqiptare.

Në përputhje me misionin e saj, Banka e Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës i bankave dhe i subjekteve të tjera që kryejnë veprimtari financiare të licencuara prej saj, ka për qëllim:

- të sigurojë veprimtari të shëndoshë bankare në harmoni të plotë me dhe në zbatim të ligjeve dhe të rregullave të vendosur nga Banka e Shqipërisë, me qëllim parandalimin e krizave financiare;
- të ruajë stabilitetin e sistemit bankar duke monitoruar dhe duke rekomanduar masat e nevojshme që bankat të administrohen në vazhdimësi siç duhet, si edhe duke nxjerrë nga tregu në momentin e duhur bankat që keqadministrohen dhe që nuk ofrojnë në mënyrë cilësore shërbimet bankare për të cilat janë licencuar;
- të ruajë dhe të forcojë besimin e publikut tek sistemi bankar dhe të përkujdeset në rritjen e sigurisë së depozituesve dhe të aksionerëve për një administrim të sigurtë dhe sa më të mirë të mjeteve të tyre;
- të kontribuojë në rritjen e transparencës së sistemit bankar duke forcuar disiplinën e tregut dhe duke rritur presionin e publikut ndaj bankave;
- të ndikojë në zhvillimin e një konkurrence të ndershme në sistemin bankar dhe më gjerë, dhe të sigurojë trajtimin e barabartë të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe të klientëve të tyre;
- të ndihmojë në krijimin e një sistemi bankar efikas, që i përgjigjet nevojave të publikut për cilësi të lartë shërbimi me kosto të arsyeshme;
- të rregullojë veprimtarinë e sistemit bankar nëpërmjet zbatimit të politikave dhe një kuadri rregullator, në përputhje me standardet dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare si edhe me kushtet specifike të vendit;
- të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që sistemi bankar të mos përdoret për veprimtari kriminale (pastrim parash, mashtrime etj.), duke bashkëpunuar për këtë qëllim me organet shtetërore respektive.

Parimet e misionit të Bankës së Shqipërisë, në rolin e saj si autoritet mbikëqyrës.

Banka e Shqipërisë, në funksion të objektivit kryesor të saj, nxit ruajtjen e aftësisë paguese, të likuiditetit dhe të funksionimit normal të sistemit bankar, të bazuar në ekonominë e tregut. Qëllimi i misionit të Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës, përcaktohet mbi disa parime, të cilat përfshijnë:

- ndërtimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një kuadri rregullativ mbikëqyrës, i cili nuk deformon kushtet e konkurrencës dhe nuk i diskriminon institucionet financiare që mbikëqyr, është në harmoni me parimet më të mira ndërkombëtare dhe është i zbatueshëm në praktikë;
- ndërtimin e politikave të cilat synojnë orientimin e sistemit bankar drejt zhvillimeve të dëshiruara;
- zbatimin rigoroz të kërkesave ligjore dhe rregullative, profesionale dhe etike, në licencimin e institucioneve financiare që aplikojnë për licencë në Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe shqyrtimin e organeve drejtuese dhe të zotëruesve të tyre (aksionerëve);
- mbikëqyrjen e vazhdueshme nëpërmjet inspektimeve në vend dhe analizës së treguesve të institucioneve të licencuara, identifikimin e problemeve, ndërmarrjen e veprimeve korrektuese dhe ndjekjen e realizimit dhe efektit të tyre;
- rritjen e transparencës në aktivitetin e ushtruar nga institucionet e licencuara;
- bashkëpunimin me institucione financiare që mbikëqyren, me institucione të tjera financiare brenda vendit si edhe me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera;
- përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.

Këto parime, realizohen nëpërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes, në këto drejtime:

- a. rregullimi i veprimtarisë së bankave të nivelit të dytë dhe të institucioneve të tjera të licencuara, si edhe mbikëqyrja e vazhdueshme e respektimit të këtyre rregullave (procesit i rregullimit bankar, procesi i inspektimit në vend dhe procesi i analizës);

Procesi i rregullimit të veprimtarisë së bankave të nivelit të dytë dhe të institucioneve të tjera financiare të licencuara, synon përcaktimin e një fushe të barabartë veprimtarie për të gjithë pjesëmarrësit e licencuar nga Banka e Shqipërisë në treg sipas natyrës së tyre, vendosjen e kufijve të caktuar për pakësimin e rrezikut që ndërmerret gjatë veprimtarisë financiare të licencuar si edhe krijimin e një kuadri me tregues të caktuar, i cili shërben për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit financiar të licencuar nga ana e mbikëqyrjes. Zbatimi i plotë i kuadrit rregullativ, vlerësohet nëpërmjet vizitave (inspektimeve) në vend dhe mbikëqyrjes nga jashtë të treguesve sasiore dhe cilësorë të veprimtarisë së bankës. Departamenti i Mbikëqyrjes, në zbatim të kompetencave të përcaktuara në aktet rregullative përkatëse, inspekton çdo zyrë bankare dhe këmbimi valutor, çdo llogari bankare dhe dokument të bankave si dhe të subjekteve të tjera, që kryejnë veprimtari bankare sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë.

- b. mbikëqyrjen e procesit të hyrjes së bankave të reja në treg dhe të institucioneve të tjera financiare jobanka (nëpërmjet procesit të licencimit);

Mbështetur në kuadrin ligjor të përcaktuar kryesisht (por jo vetëm) nga ligji “Për Bankën e Shqipërisë” dhe ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe për mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë.

Me aktet nënligjore dhe normative të nxjerra, Banka e Shqipërisë ka vendosur kërkesat minimale të domosdoshme për subjektet që kërkojnë të marrin licencë si bankë, si subjekt jobankë, si shoqëri e kursim-kreditit etj..

Shqyrtimi i kërkesave për marrjen e licencës bëhet mbështetur në procedura transparente, bazuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në praktikën e përvojën licencuese ndërkombëtare.

Duke respektuar pavarësinë ligjore, operacionale, financiare dhe administrative të bankave, Banka e Shqipërisë në funksion dhe në zbatim të ligjit, shqyrton kërkesat e bankave dhe jep miratime paraprake ose refuzon kërkesat për: përfundimin e marrëveshjeve të binjakëzimit, lejimin e kryerjes së veprimtarive financiare shtesë, zmadhimin e kapitalit me mjete jolikuide, zvogëlimin e kapitalit, riblerjen e aksioneve nga banka, emërimin e një ose të disa administratorëve, që banka të bashkojë, të ndajë, të shkrijë ose të shesë aktivitet etj..

- c. shqyrtimin dhe miratimin e organeve drejtuese të bankës si edhe vlerësimin e vazhdueshëm të rolit të tyre në mbarëvajtjen e veprimtarisë së bankës;

Ky është një moment i cili fiton rëndësi maksimale në kushtet kur administrimi i lartë i bankës është përcaktues në ecurinë e saj. Procesi mbikëqyrës, krahas përcaktimit të kritereve kryesore morale, profesionale dhe etike, i njeh drejtuesve të bankës përgjegjësinë dhe meritat për mbarëvajtjen e saj si edhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme punën e tyre.

- d. mbikëqyrjen e ecurisë financiare të bankës dhe të sistemit bankar (procesi i analizës së bankave dhe të sistemit bankar);

Treguesit financiarë të veprimtarisë së një banke të caktuar dhe të sistemit bankar në përgjithësi, ndiqen nga ana e Departamentit të Mbikëqyrjes në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet shqyrtimit të pasqyrave të ndryshme financiare dhe treguesve që ato dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, me anë të sistemit raportues të unifikuar. Mbi bazën e këtyre të dhënave, arrihet në konkluzione mbi ecurinë e treguesve të ndryshëm, identifikohen problemet dhe ndërtohen pritjet mbi ecurinë e tyre në të ardhmen e afërt, si edhe nxirren rekomandimet përkatëse.

- e. mbikëqyrjen e procesit të trajtimit të bankave dhe të institucioneve të tjera financiare të licencuara me probleme (nga marrja e veprimeve korrektuese deri tek revokimi i licencës);

Për institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat paraqesin probleme shqetësuese për veten e tyre dhe/ose për të gjithë sistemin (vërehen shkelje të dispozitave të ligjeve apo të çdo akti nënligjor të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë, shkelje të çdo kushti që i bashkëlidhet licencës, shkelje të marrëdhënieve të besimit, ushtrimi i veprimtarisë së pasigurt dhe të paqëndrueshme etj.), në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullativ, rekomandohen veprime korrektuese. Këto veprime korrektuese, krahas masave për t'u ndërmarrë dhe për të realizuar përmirësimin e treguesve, përfshijnë vendosjen e penaliteteve për institucionin financiar të licencuar dhe/ose për drejtuesit e tij, deri edhe vendosjen e një banke nën administrim (kujdestari) për një periudhë kohe të caktuar. Nëse gjykohet e nevojshme, veprimet korrektuese mund të përfshijnë edhe revokimin përfundimtar të licencës për të ushtruar aktivitetin dhe likuidimin e saj.

- f. krijimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, me institucione financiare brenda vendit;

Në funksion të kryerjes së aktivitetit mbikëqyrës, vendosen dhe forcohen marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet financiare që licencohen (organet drejtuese dhe aksionerët e tyre) dhe me institucione të tjera financiare, fusha e veprimit të të cilave lidhet me veprimtarinë e institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Këtu futen institucionet shtetërore, autoritetet mbikëqyrëse të institucioneve financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë, shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, institucionet që mbikëqyrin instrumente të ndryshme dhe tregjet e tyre etj..

- g. krijimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, me autoritetet mbikëqyrëse në vende të tjera;

Në kryerjen e funksionit të saj, Mbikëqyrja mbështetet në bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse së vendeve të huaja, ku janë të vendosura kompanitë-mëmë të institucioneve financiare të licencuara në vend, ose ku ndodhen degët apo filialet e bankave dhe të institucioneve të tjera financiare të licencuara me qendër në Shqipëri. Ky bashkëpunim, institucionalizohet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit (ose dokumenteve të tjera) midis autoriteteve respektive të të dyja vendeve.

- h. përmirësimin të kapaciteteve mbikëqyrëse;

Ky mbetet një parim i vazhdueshëm i funksionit të Mbikëqyrjes Bankare. Realizimi i tij konceptohet si një proces, i cili do të realizojë forcimin e burimeve njerëzore që angazhohen në aktivitetin mbikëqyrës dhe përmirësimin e aftësive të tyre, si edhe do të mundësojë adoptimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes në harmoni me standardet ndërkombëtare.

2. VEPRIMTARIA BANKARE DHE MBIKËQYRJA

Veprimtaria e sistemit financiar dhe e atij bankar në Shqipëri, zhvillohet në një ekonomi të hapur, e cila gjithnjë e më tepër po integrohet në ekonominë evropiane dhe atë botërore. Për këtë arsye, është e pritshme që zhvillime të rëndësishme ndërkombëtare, veçanërisht ato me ndikim në veprimtarinë e tregjeve financiare ndërkombëtare, të kenë ndikim edhe mbi ekonominë e vendit tonë si edhe mbi tregun tonë financiar dhe aktorët e tij. Në këtë mënyrë, është e rëndësishme që këto zhvillime të ndiqen dhe të analizohen në vazhdimësi, për të identifikuar zhvillimet që mund të kenë pasoja negative në sistemin financiar në vend dhe për të marrë masa për mbrojtjen e tij.

2.1 Disa fjalë mbi ambientin ekonomik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Eurozonë dhe në Shqipëri.

Gjatë vitit 2003, Banka Qendrore Evropiane dhe Banka e Rezervës Federale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vazhduan të ndjekin një politikë monetare lehtësuese në mbështetje të nxitjes së zhvillimit të ekonomive të tyre.

Kështu, Rezerva Federale uli normat bazë të interesit në mbledhjen e muajit qershor, duke i zbritur ato në nivelin më të ulët të 40 viteve të fundit, 1 për qind (kundrejt 1.5 për qind në fillim të vitit). Ulja e normave të interesit pasqyrooi shqetësimet e bankës qendrore në lidhje me rreziqet deflacioniste në ekonominë amerikane. Duhet theksuar se, uljet e normave të interesit, së bashku me politikat mbështetëse fiskale, kanë dhënë rezultatet e tyre në rigjallërimin e ekonomisë amerikane në pjesën e dytë të vitit, ku ajo shënoi një rritje prej 4 për qind.

Gjatë vitit 2003, Banka Qendrore Evropiane uli normën bazë të ekonomisë dy herë duke e çuar atë në 2.00 për qind kundrejt 2.75 për qind në fillim të vitit. Uljet e normave të interesit u kryen në fillim të muajve mars (2.50 për qind) dhe qershor (2.00 për qind), me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike. Megjithatë, ekonomia e rajonit të euros, vazhdoi të shënojë ritme të ulëta të rritjes ekonomike. Gjatë tremujorëve, shifrat e rritjes ekonomike ishin përkatësisht 0.0 për qind, -0.1 për qind, 0.4 për qind dhe 0.3 për qind.

Në tremujorin e katërt të vitit 2003, ekonomia në Eurozonë u rrit nën parashikimin prej 0.4 për qind. Ndikimin negativ në rritjen ekonomike, e kanë dhënë kryesisht reduktimi i eksporteve neto dhe dobësia e kërkesës së brendshme. Ekonomitë e tre vendeve kryesore në Eurozonë,

shënuan rritje ekonomike më të ulët se pritjet. Kështu, Gjermania u rrit vetëm me 0.2 për qind, Franca me 0.5 për qind dhe Italia prezantoi të njëjtin nivel të produktit të brendshëm bruto me tremujorin e kaluar.

Zhvillimet në Eurozonë dhe në ShBA kanë dhënë efektin e tyre edhe në disa zhvillime të sistemit bankar në Shqipëri, nëpërmjet politikave të ndjekura mbi normat e interesit në usd dhe euro si edhe rrjedhëve në ecurinë e kursit të këmbimit. Kështu, rënia e normave të interesit në zonat më të rëndësishme të ekonomisë botërore, e ka bërë edhe më tërheqëse kredinë në monedhë të huaj të akorduar në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, ecuria mbiçmuese e kursit të këmbimit të lekut ndaj usd dhe euro, e cila ka reflektuar kryesisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, ka influencuar negativisht në kapitalin bazë të bankave. Përveç kësaj, mbiçmimi i lekut, ka ndikuar negativisht në rritjen e totalit të aktiveve të sistemit bankar, në kushtet kur një pjesë e mirë e burimeve të sistemit evidentohen në monedhë të huaj.

Në Shqipëri, shifrat e ekonomisë për vitin 2003 konfirmuan rritjen ekonomike dhe realizimin e objektivave kryesorë makroekonomikë në vend. Rritja reale e treguesit të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) vlerësohet 6 për qind ose 1.3 për qind më e lartë se në vitin 2002. Kjo rritje i dedikohet kryesisht rritjes në sektorin e ndërtimit, të shërbimeve dhe të transportit, ndërkohë që shifrat për industrinë dhe bujqësinë mbeten modeste.

Niveli i inflacionit në fund të muajit dhjetor u evidentua 3.3 për qind, duke ruajtur kufijtë e objektivit për inflacionin (2-4 për qind) në programin monetar të Bankës së Shqipërisë. Ruajtja e niveleve të tilla të inflacionit është tregues i gjetjes së një ekuilibri të kënaqshëm midis politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe politikës fiskale të ndjekur nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ecuria dhe parashikimet e inflacionit në ekonomi, si dhe nevoja për të ruajtur stabilitetin financiar të vendit, diktuan zbutjen e politikës monetare gjatë vitit 2003. Kështu, Banka e Shqipërisë bëri disa ulje të normës bazë të interesit me nga 0.5 pikë përqindjeje respektivisht në muajt prill, korrik, tetor dhe dhjetor, të cilat bënë që në fund të vitit norma bazë e interesit (norma e interesit e aplikuar në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes) të zbriste në nivelin 6.5 për qind.

Gjatë vitit 2003, monedha vendase shfaqti një ecuri mbiçmuese kundrejt dy valutave kryesore, e cila ishte më e ndjeshme gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, respektivisht 3.8 për qind ndaj euros dhe rreth 7.8 për qind kundrejt dollarit amerikan.

Sektori i jashtëm i vendit u karakterizua nga një rritje e konsiderueshme e të ardhurave dhe shpenzimeve korente, si rezultat i një aktiviteti në rritje të këtij sektori. Llogaria korente, ndonëse njohu një deficit rreth 6.7 për qind të PBB-së ose 2 pikë përqindjeje më të ulët se ai i vitit 2002, ka shënuar rritje të këtij deficiti, ky i fundit në terma absolutë. Kjo shpjegohet me rritjen e nivelit të konsumit të ekonomisë shqiptare, ndërkohë që dikton nevojën e rritjes së kapaciteteve prodhuese e konkurruese të saj. Në vazhdim, flasim për një pozicion të përgjithshëm pozitiv të bilancit të pagesave dhe niveli në rritje të rezervave valutore, të cilat shënuan shifrën mbi 1 miliard dollarë amerikanë në fund të vitit.

2.2 Analiza e sistemit bankar

Tregu bankar prezantoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003, i mbështetur edhe nga një mjedis makroekonomik i favorshëm. Hyrja e dy bankave të reja dhe privatizimi i Bankës së Kursimeve nga një investitor i rëndësishëm në Evropën Qendrore dhe Lindore, premtojnë rritjen e produktivitetit dhe të konkurrencës në sistem.

2.2.1. Aktivitet e sistemit bankar, struktura dhe cilësia e tyre.

Aktivet e sistemit bankar janë rritur me 34.3 miliardë lekë ose 10.1 për qind në krahasim me fundvitin 2002. Kjo rritje i atribuohet si “Veprimeve me thesarin dhe ndërbankare”, ashtu dhe “Kredidhënies” bashkë me “investimet në letrat me vlerë”. “Veprimet me thesarin dhe

ndërbankare” janë rritur 12.3 miliardë lekë, “Kredihënia” shënon rritje 11.9 miliardë lekë dhe “Investimet në letrat me vlerë” janë rritur me 3.4 miliardë lekë. Kontributi më lartë i këtyre dy zërave të fundit, tregon shtrirjen e veprimeve të sistemit bankar drejt aktiviteteve më frytdhënëse.

Tabelë I. Totali i aktiveve, ecuria në vite.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5	339.3	373.6
Në % ndaj PBB	49.2	50.2	53.5	51.6	50.2 ¹

Në analizën sipas grupbankave të sistemit², krahasuar me fundin e vitit 2002, grupi i bankave me kapital shtetëror (G1) shënon rritje të totalit të aktiveve për 10.4 miliardë lekë, grupi i bankave me kapital të përbashkët (G2) shënon rritje për 0.86 miliardë lekë dhe grupi i bankave me kapital privat (G3) shënon rritje me 23.1 miliardë lekë. Ecuria e kënaqshme e grupit të bankave private, rritja e të cilit tejkalon rreth dy herë rritjen e dy grupeve të tjera, tregon eficiencën e administrimit privat edhe në veprimtarinë bankare.

Fig.1. Peshë e grupbankave në sistemin bankar sipas totalit të aktiveve, për fundvitin'03.





Fig.2. Peshë e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve (për disa periudha kohore).



¹ Rënia e peshës është pasojë e aplikimit të metodës së re llogaritëse për PBB-në e vlerësuar.

² Ndërsa *de facto* është përfunduar privatizimi i Bankës së Kursimeve, në fund të vitit 2003 *de jure* kapitali i saj është ende shtetëror dhe në proces transferimi.

Grafiku i mësipërm, konfirmon tendencën në rënie të peshës në treg për grupin G1, ecurinë pozitive të grupit G3 dhe gjendjen statike të grupit të bankave me kapital të përbashkët. Viti 2003, i bëri edhe më të krahasueshme peshat në treg të grupeve G1 dhe G3. Privatizimi i Bankës së Kursimeve, pritet të ketë efektet e tij në forcimin e konkurrencës në treg, por efektet e tij në strukturën e sistemit bankar janë të vështira për t'u parashikuar. Nëse bankat e tjera shumë më të vogla, nuk gjejnë mënyra të zgjerimit të shpejtë të aktivitetit të tyre, ato do të vihen përpara vështirësisht të konsiderueshme, që mund të kenë si rezultat humbjen e mëtejshme të peshës së tyre.

2.2.2 Struktura e aktiveve.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar në fund të vitit 2003, sipas zërave kryesorë, paraqitet si më poshtë:

“Veprimet me thesarin dhe ndërbankare”, që me fillimin e vitit 2002, evidentojnë një ritëm rritjeje më të ulët se ai i totalit të aktiveve, gjë e cila shpjegon dhe peshën e tyre në rënie. Ndonëse për vitin 2003 ky grup shënon rritje me 4.5 për qind, disa herë më të lartë se rritja e shënuar në vitin 2002 prej 0.3 për qind, tendenca në rënie e peshës së tij ndaj totalit të aktiveve flet për zgjerim të aktivitetit bankar në drejtime të tjera dhe për diversifikim të portofolit të sistemit bankar.

Zëri “Marrëdhëniet me bankën qendrore”, përsa i takon ritmit të ndryshimit, shfaq një ecuri jo të rregullt. Për vitin 2001 ky zë rritet me 12.2 për qind, për vitin 2002 pëson një rënie prej 5.1 për qind ndërsa për vitin 2003 shënon rritje prej 9.9 për qind. Megjithatë, pesha e këtij zëri ndaj totalit të aktiveve, ruhet e njëjtë për të dy vitet e fundit, në nivelin 8.7 për qind.

Zëri “Investime në bono thesari”, vazhdon të evidentojë një peshë të konsiderueshme në strukturën e aktiveve të sistemit bankar, prej 49.6 për qind. Por ky tregues ka ardhur në rënie, si rezultat i rritjes së tij me një ritëm më të ulët se rritja e totalit të aktiveve.

Zëri “Marrëdhëniet me bankat e tjera”, përfaqëson kryesisht vendosjet e bankave në bankat e tjera. Zgjerimi i aktiviteteve të sistemit bankar në drejtime të tjera (kredidhënie dhe investime në letra me vlerë), është shoqëruar me rënien e peshës së këtij zëri në totalin e aktiveve.

Kredidhënia³, pavarësisht peshës së saj të kufizuar (vetëm 13.5 për qind e totalit të aktiveve), prezanton një aktivitet në rritje për sistemin bankar shqiptar (me 30.7 pikë përqindjeje kundrejt fundvitit 2002).

“Investimet në letrat e tjera me vlerë” shfaqen gjithnjë e më të rëndësishme në strukturën e aktiveve të sistemit bankar. Në fund të vitit 2003, evidentohen 7 banka të sistemit me një portofol të tillë, nga 3 banka në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Duhet përmendur se investimet në obligacionet dyvjeçare të Qeverisë Shqiptare, luajnë një rol të konsiderueshëm në zgjerimin e këtij portofoli.

³ Në tabelën nr. 2 i korrespondon zëri “Veprimet me klientët”.

Tabelë 2 . Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar.

Treguesit (në miliardë lekë):	Dhjetor 2000		Dhjetor 2001			Dhjetor 2002			Dhjetor 2003		
	Shuma	Pesha	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi***	Shuma	Pesha	Ndryshimi	Shuma	Pesha	Ndryshimi
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto :	239.5	88.4	272.9	85.7	13.9	273.6	80.6	0.3	286	76.5	4.5
Marrëdhënie me bankën qendrore	27.9	10.3	31.3	9.8	12.2	29.7	8.7	-5.1	32.6	8.7	9.9
Bono thesari	150.2	55.5	164.6	51.7	9.6	174.9	51.6	6.3	185.4	49.6	5.9
Marrëdhënie me bankat e tjera	55.8	20.6	59.9	18.8	7.3	62.1	18.3	3.7	60.4	16.2	-2.8
2. Veprime me klientët (bruto)	28.2	10.4	28.3	8.9	0.4	38.7	11.4	36.7	50.6 ⁴	13.5	30.7
3. Veprime me letrat me vlerë	7.7	2.9	10.6	3.3	37.7	16.9	5.0	59.4	20.3	5.4	20.1
4. Mjete të tjera	1.5	0.6	1.2	0.4	-20.0	3.2	0.9	166.7	3	0.8	-5.2
5. Mjete të qendrueshme	5.1	1.9	5.6	1.8	9.8	6.4	1.9	14.3	5.7	1.5	-9.2
Totali i Aktiveve	270.8	100.0	318.5	100.0	17.6	339.3	100	6.5	373.6	100.0	10.1

* në miliardë lekë.

** në përqindje.

*** në përqindje.

2.2.3 Aktiviteti kreditues.

Krahasuar me vitin 2002, kredia e re e lëvruar gjatë vitit 2003 arriti vlerën 92.7 miliardë lekë rreth 1.5 herë më shumë, ndërsa teprica e kredisë shënoi rritje prej 11.9 miliardë lekësh (ose 30.5 për qind).

Si rezultat i rritjes së lëvrimin të kredisë afatmesme dhe afatgjatë, pesha e kredisë afatshkurtër ka ardhur në rënie. Por, ritmi i lëvrimin të kredisë afatshkurtër është ende i lartë.

Teprica e kredisë në lekë, shënon rënie të peshës së saj ndaj totalit të kredisë, një ecuri e ndryshme nga ajo e vitit 2002.

⁴ Kjo vlerë është madhësia e tepricës bruto të kredisë pa interesat e përlogaritur. Së bashku me këta të fundit, teprica bruto e kredisë rezulton 50.8 miliardë lekë në fundvitin'03.

Fig. 3. Teprica e kredisë bruto, ecuria tremujore kumulative (në miliardë lekë).




Fig. 4. Ndryshimet e tepricës së kredisë së sistemit bankar për disa periudha tremujore.





Fig. 5. Kredia e re e akorduar nga sistemi bankar (në miliardë lekë).



2.2.4 Cilësia e aktiveve

Treguesi “kredi me probleme / tepricës së kredisë (bruto)”, i cili konsiderohet si tregues kryesor i cilësisë së këtij portofoli, evidenton rënie gjatë vitit 2003. Reduktimi i këtij treguesi është shkak i ritmit rritës më të ulët të kredive me probleme kundrejt tepricës së kredisë. Kështu, teprica e kredisë shënoi rritje me 30.5 për qind nga fundviti 2002, ndërkohë që kreditë me probleme u rritën vetëm me 8.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë. Ecuria e klasifikimit të kredisë, pasqyruar në tabelën e mëposhtme, tregon përmirësimin e cilësisë së portofolit në fundvitin 2003.

Tabela 2. Klasifikimi i kredisë.

Klasifikimi i kredisë (në % ndaj tepricës së kredisë).	Tremujori i parë'03.	Tremujori i dytë'03.	Tremujori i tretë'03.	Tremujori i katërt'03.
Kredi standarde	90.3	91.8	91.6	92.3
Kredi në ndjekje	3.6	30.	3.2	3.1
Kredi nënstandarde	2.5	2.3	2.4	1.9
Kredi të dyshimta	0.2	0.2	0.3	0.5
Kredi të humbura	3.4	2.6	2.5	2.1

Treguesi “kredi me probleme / tepricës së kredisë” mbi baza neto⁵, tregon madhësinë e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të kreditit. Vlerat e ulëta dhe madje në rënie të këtij raporti, flasin për një ekspozim përgjithësisht të kufizuar ndaj këtij rreziku.

2.3 Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.

Niveli i fondeve nga të tretët - depozitat dhe llogaritë rrjedhëse - në totalin e fondeve të bankave të sistemit, evidentohet 87,5 për qind nga 84,6 për qind që evidentohet ky tregues në fundin e vitit 2002.

Gjatë vitit 2003, ecuria e depozitave të sistemit njohu rritje të qëndrueshme. Në krahasim me fundin e vitit 2002, niveli i depozitave të sistemit evidentoi rritje me 14.7 për qind ose 42.4 miliardë lekë. Viti 2002, krahasuar me vitin 2001, shënoi një rritje shumë më modeste, 4 për qind ose 11.2 miliardë lekë.

Tabela 3. Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor 2002	Mars 2003	Qershor 2003	Shtator 2003	Dhjetor 2003
Totali i depozitave & llogarive rrjedhëse	289.0	302.4	315.2	329.7	331.4

Në sistemin bankar, bankat private dhanë ndikimin kryesor në rritjen e nivelit të depozitave me 21.6 miliardë lekë, Banka e Kursimeve ndikoi me një rritje prej 18.9 miliardë lekësh, ndërsa kontributi i bankave me kapital të përbashkët vazhdon të jetë modest me rreth 2 miliardë lekë.


Banka e Kursimeve vazhdon të zotërojë nivelin më të lartë të depozitave të sistemit, pavarësisht kontributit në rritje të bankave private. Privatizimi i Bankës së Kursimeve, si banka më e madhe e sistemit me kapital shtetëror, ndonëse nuk parashikon të ndikojë ndjeshëm në nivelin e depozitave të kësaj të fundit, pritet të shoqërohet me një investim më efektiv të tyre.

⁵ Mbas zbritjes së fondeve të provigjonimit.

Tabela 4. Pozicioni i Bankës së Kursimeve në aktivitetin depozitues të sistemit bankar

Treguesi në % ndaj sistemit bankar	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Mars 2003	Qershor 2003	Shtator 2003	Dhjetor 2003
Totali i depozitave & llogarive rrjedhëse	63.7	58.3	58.1	58.0	56.5	56.5


Fig.6. Ecuria e depozitave të sistemit sipas grupbankave.



Në fund të vitit 2003, në strukturën e depozitave të sistemit, depozitat në lekë përbënin 70 për qind, depozitat me afat 82 për qind dhe depozitat e pranuar nga individët 86 për qind të totalit të depozitave të sistemit. Nëse analizojmë tre grupbankat e sistemit, prirja në strukturë është e njëjtë, duke evidentuar një rritje të rëndësishme të depozitave me afat dhe të depozitave në lekë të individëve. Rënia e normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, megjithë ndërveprimin e saj me uljen e normës së interesit për depozitat në lekë në gjysmën e dytë të vitit, nuk ndikoi në rënien e nivelit të depozitave. Në fakt, depozitat në lekë evidentuan rritje me 15.7 për qind ose 36.4 miliardë lekë, kundrejt një rritjeje 6 për qind ose 6 miliardë lekë, që evidentuan depozitat në valutë⁶. Rritja e depozitave në lekë dhe në valutë pranë sistemit bankar, tregon gjithashtu për një konsolidim të besimit të publikut dhe rritje të kulturës së tij mbi depozitimin e kursimeve në sistemin bankar.

Fig.7. Ecuria e depozitave të sistemit.

Fig.7a. Sipas disponibilitetit.



⁶ Normat e interesit për depozitat në euro dhe në dollarë shënuan rënie gjatë vitit 2003 si rezultat i rënies së këtyre normave në tregjet ndërkombëtare.

Fig.7b. Sipas sektorëve.





Fig. 7c. Sipas monedhës.



2.4 Efektiviteti

Rezultati financiar i sistemit bankar në fundvitin 2003 është pozitiv dhe në nivele të kënaqshme. Të ardhurat neto rezultuan rreth 4,45 miliardë lekë ose 0.6 për qind e PBB-së. Krahasuar me fundvitin 2002, të ardhurat neto të sistemit janë 0,6 miliardë lekë ose 14,4 për qind më të larta (në terma realë, kjo rritje llogaritet 11.4 për qind)⁷.

Tabela 5. Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, rezultati financiar.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i të ardhurave	39.1	31.0	29.2	28.0	32.0
Totali i shpenzimeve	37.9	25.7	24.9	24.1	27.6
E ardhura neto (fitimi)	1.2	5.3	4.3	3.9	4.4

⁷ Rënia (rritja) reale llogaritet : $1 + \text{norma nominale} = 1 + \text{norma reale} + \text{norma e inflacionit}$

E ardhura neto nga aktiviteti kryesor i sistemit bankar rezulton 13.3 miliardë lekë. Krahasuar me fundvitin 2002, e ardhura neto është rritur 2,1 miliardë lekë ose 18.8 për qind. Nga këto të ardhura, rreth 84 për qind e përbëjnë të ardhurat neto nga interesat, të cilat vazhdojnë të japin kontributin kryesor në të ardhurën neto, ndërsa pjesa tjetër rrjedh kryesisht nga komisionet dhe nga veprimtaria valutore.

Tabela 6. Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktiviteti kryesor, e ardhura neto.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Të ardhurat nga veprimtaria kryesore	37.5	27.0	26.1	26.9	31.1
Shpenzime për veprimtarinë kryesore	31.1	17.1	15.0	15.7	17.8
E ardhura neto	6.4	9.9	11.1	11.2	13.3
Nga kjo : e ardhura neto nga interesat	5.2	7.7	8.7	8.8	11.2

Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë⁸ për sistemin bankar rezultojnë 6.1 miliardë lekë, duke evidentuar rritje me 0.6 miliardë lekë krahasuar me vitin 2002. Kjo rritje shpjegohet me zgjerimin e investimeve për rrjetin e degëve të bankave, për sistemet e teknologjisë së informacionit etj.. Ndërkohë, shpenzimet për provigjone evidentojnë rënie me 155 milionë lekë.

Tabela 7. Raporti i efikasitetit.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë (1)	3.2	4.0	4.8	5.5	6.1
Të ardhurat bruto të veprimtarisë (2)	4.8	11.5	10.4	10.2	12.4
Raporti i efikasitetit (1)/(2)*100	65.9	34.5	46.3	54.5	49.2 ⁹

Rezultatet e politikave dhe të vendimeve të administrimit të bankave, reflektohen në treguesit e rentabilitetit. Vlera pozitive e kthimit nga aktivet (ROA-së) prej 1.24 për qind, tregon aftësinë e sistemit bankar për të operuar në tërësi me fitim, ndërsa niveli i lartë i kthimit mbi kapitalin (ROE-së) prej 19.5 për qind, tregon mundësinë e rritjes së investimeve. Këta tregues, evidentohen brenda niveleve normale¹⁰.

Tabela 8. Tregues të rentabilitetit, ecuria në vite.

Treguesi në %	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
ROA*	0.5	2.1	1.5	1.2	1.24
ROE**	15.7	20.6	21.6	19.2	19.5

*Kthyeshmëria nga aktivet.

**Kthyeshmëria nga fondet e veta.

2.5 Mjaftueshmëria e kapitalit.

Në fund të vitit 2003 niveli i fondeve të veta (kapitalit aksioner) të sistemit shënon vlerën 22 miliardë lekë ose rreth 0.4 miliardë lekë më shumë se në vitin 2002. Një analizë më e hollësishme e ecurisë së elementeve kryesore përbërëse të kapitalit aksioner, nxjerr në pah dhe kontributin e tyre në nivelin e tij.

⁸Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë përfshijnë shpenzimet për personelin, shpenzimet për shërbimet e jashtme, amortizimin dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme.

⁹ Rënia e raportit të efikasitetit është rrjedhojë e ritmit më të lartë rritës të të ardhurave në krahasim me shpenzimet e veprimtarisë.

¹⁰ Niveli normal i ROA konsiderohet 0,5 – 1,6 % , ndërsa për ROE konsiderohet 10 – 20 %.

Tabela 9. Struktura e kapitalit aksioner.


Treguesi	Dhjetor 2001		Dhjetor 2002		Dhjetor 2003	
	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	në %
Kapitali i vet aksioner	18,760.0	100.0	21,592.2	100.0	21,984.9	100.0
Kapitali i paguar ¹¹	14,052.2	74.3	14,516.6	65.6	18,512.3	69.3
Rezervat	3,274.7	17.4	4,199.6	19.4	4,517.5	20.5
Diferenca rivlerësimi	-117.7		-354.6		-3,285.8	
Fitimi (humbja) e pashpërndarë ¹²	88.8	0.5	536.7	2.5	-180.9	
Fitimi (humbja) e vitit në vazhdim	1,462.0	7.8	2,693.9	12.5	2,422.0	10.2

Kapitali i paguar, i cili përbën elementin kryesor të kapitalit aksioner shënon një rritje të konsiderueshme me 27.5 për qind ose rreth 4 miliardë lekë¹³. Ky element, jep ndikimin kryesor në nivelet e kapitalit aksioner krahas fitimit të vitit, ndërkohë që diferencat e rivlerësimit si rezultat i nënçmimit të dollarit amerikan kundrejt lekut, japin ndikim të ndjeshëm negativ¹⁴.

Në fund të vitit 2003, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit¹⁵ për sistemin bankar evidentohet 28.5 për qind, nga 31.6 për qind që evidentohet në fund të vitit 2002. Niveli i kapitalit rregullator dhe i aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut, u rritën respektivisht me 1.2 për qind (rreth 207 milionë lekë) dhe 12.2 për qind (6.8 miliardë lekë) krahasuar me fundvitin 2002. Pikërisht, ritmet më të larta të rritjes së aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut, shpjegojnë edhe rënien e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Analiza e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave të sistemit bankar, evidenton rënie të raportit në grupin e bankave private dhe ato me kapital të përbashkët, ndërkohë që raporti rezulton i rritur në Bankën e Kursimeve. Kështu, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin e bankave me kapital privat rezulton 24,4 për qind, për grupin e bankave me kapital të përbashkët 32,7 për qind dhe për grupin e bankave me kapital shtetëror 54,9 për qind. Nivelet e larta të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit në Bankën e Kursimeve parashikojnë të bien pas privatizimit, në kushtet e angazhimit të pritshëm në aktivitetin kredidhënës dhe forma të tjera të investimit të fondeve.

Fig.8. Ecuria e kapitalit rregullator, e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut dhe e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në vite



¹¹ Peshat në përqindje të kapitalit të paguar llogariten duke marrë në konsideratë edhe diferencat e rivlerësimit.


¹² Peshat në përqindje të fitimit të vitit 2003 llogaritet duke marrë në konsideratë edhe humbjen e pashpërndarë të vitit të kaluar.

¹³ Rritja e nivelit të kapitalit të paguar është rezultat i shtimit të dy bankave të reja në sistem dhe shtimit të kapitalit të disa bankave.

¹⁴ Diferencat debitorë të rivlerësimit të kapitalit gjatë vitit 2003 ndikuan negativisht në disa banka të sistemit, niveli i kapitalit bazë të të cilave rezultoi nën nivelin e kapitalit minimal të kërkuar.

¹⁵ Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit jepet si raport i kapitalit rregullator ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun.

Fig.9. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave (në %)



Nivelet e larta të mjaftueshmërisë së kapitalit, i paraqesin të kapitalizuara bankat e sistemit. Ndonëse nivelet e kapitalit bazë për disa banka bien nën ato minimale të kërkuara, aksionerët angazhohen t'i plotësojnë këto diferenca në vazhdim.


2.6 Likuiditeti

Analiza e likuiditetit, bazohet në analizën e treguesve kryesorë të tij si raportet e likuiditetit¹⁶, diferencat (gap-in) e maturimit dhe raporti i kredisë ndaj depozitave.

Në fund të vitit 2003, raporti i aktiveve likuide¹⁷ në totalin e aktiveve për sistemin bankar dhe bankat e tij evidentohet në nivel të kënaqshëm, mbi 30 për qind.

Treguesi i mësipërm mbështetet edhe nga (2) raporti i "aktiveve afatshkurtra/pasive afatshkurtra" që për sistemin bankar evidentohet 107.1 për qind ose 25.8 pikë përqindjeje më i ulët se në fund të vitit 2002. Ky tregues konsiderohet i kënaqshëm për sistemin bankar, ndonëse ai njih një rënie, e cila shpjegohet me rritjen me ritme më të larta të pasiveve afatshkurtra (26.4 për qind ose 29.5 miliardë lekë) krahasuar me aktivet afatshkurtra me (1.9 për qind ose 2.8 miliardë lekë).

Fig.10. Ecuria e raportit aktive afatshkurtra/pasive afatshkurtra për sistemin dhe grupbanka



¹⁶ Këto raporte janë aktive likuide ndaj totalit të aktiveve dhe aktive afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra.

¹⁷ Në zërin "aktive likuide" përfshihen: mjetet monetare, marrëdhëniet me BSH-llogari të tjera, bonot e thesarit, marrëdhëniet me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare dhe letrat me vlerë (neto).

Diferenca e maturimit midis aktiveve dhe pasiveve me maturim të mbetur deri në një muaj evidenton vlera negative të konsiderueshme për dy banka të sistemit, por niveli i kënaqshëm i aktiveve likuide të këtyre bankave nuk i ekspozon ato ndaj rrezikut të likuiditetit.

Lidhur me treguesin e raportit të tepriçës së kredisë neto ndaj depozitave mesatare - si tregues indirekt i likuiditetit në sistem - disa banka evidentohen edhe në fund të vitit me nivele të larta (mbi 70 për qind)¹⁸ të raportit të kredisë ndaj depozitave. Por, në këto banka vërehen nivele të mjaftueshme të kapitalit dhe nuk evidentohen tregues shqetësues të cilësisë së portofolit të kredive.

Në një kuadër më të përgjithshëm, të dhënat operative mbi tregun ndërbankar dhe mbi përdorimin e lehtësive kredituese të Bankës së Shqipërisë, flasin për një sistem me tepriçë likuiditeti. Treguesit e likuiditetit në nivele të kënaqshme, nuk e ekspozojnë sistemin dhe bankat e tij ndaj rrezikut të likuiditetit.

Treguesit e mësipërm, flasin përgjithësisht për një gjendje të mirë të sistemit bankar nga pikëpamja e treguesve financiarë, gjatë vitit 2003.

2.7 Mbikëqyrja në vend

Banka e Shqipërisë është e ngakuar me ligj për kryerjen e rolit të saj si institucion rregullues dhe mbikëqyrës i sistemit bankar në Shqipëri, funksion të cilin e ka ushtruar me përgjigjësi gjatë vitit 2003. Krahas sistemit bankar, janë rregulluar dhe mbikëqyrur edhe subjekte të tjera financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë, si institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim- kreditit dhe zyrat e këmbimit valutor¹⁹.

Mbikëqyrja është realizuar nëpërmjet inspektimeve të plota dhe/ose të pjesshme pranë institucioneve financiare të licencuara (IFL), si edhe analizës dhe mbikëqyrjes nga jashtë. Secila bankë është inspektuar në mënyrë të plotë, të paktën një herë gjatë vitit. Inspektime të pjesshme janë kryer në mënyrë të vazhdueshme pranë IFL, për të vlerësuar ecurinë e drejtimeve të ndryshme të aktivitetit të tyre, administrimin e rrezikut, mirëfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj..

Sistemi raportues, nëpërmjet të cilit bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë treguesit kryesorë të aktivitetit të tyre, është instrumenti kryesor i realizimit të mbikëqyrjes nga jashtë. Në bazë të agregimit dhe analizës së këtyre të dhënave, arrihet në konkluzione të rëndësishme për të gjithë publikun, lidhur me gjendjen e sistemit bankar dhe prirjen e curisë së tij të mëtejshme. Analiza e ecurisë së sistemit bankar e trajtuar më lart është ndërtuar mbi bazën e këtyre të dhënave.

Përsa i takon inspektimeve në vend, si element vlerësimi përdoret sistemi "CAMELS", i cili realizon një analizë cilësore të disa elementeve të veprimtarisë së bankës duke përfshirë kapitalin, cilësinë e aktiveve, administrimin (menaxhimin) e bankës, të ardhurat, situatën e likuiditetit, ndjeshmërinë e zërave të bilancit të saj ndaj lëvizjeve në normën e interesit dhe në kursin e këmbimit etj.. Mbështetur në këta përbërës, ky sistem siguron një vlerësim të gjendjes së përgjithshme financiare të bankës. Sipas këtij sistemi vlerësimi, gjendja e përgjithshme financiare e sistemit bankar gjatë vitit të kaluar, vlerësohet "e kënaqshme" ose e shprehur në vlerë numerike "2" (shkalla e renditjes sipas "CAMELS" varion nga "1", vlerësimi më i mirë, deri në "5", vlerësimi më i dobët).

Krahasuar me gjendjen e përgjithshme mesatare të vitit 2002, rezulton e njëjta renditje. Por vërehet se disa banka të renditura "1" gjatë vitit 2002, kanë kaluar "2" në vitin 2003, ndërkohë që për disa banka të tjera që nuk kanë pësuar ulje në renditjen e përgjithshme, ka patur ndryshime në vlerësimin e elementeve të veçanta përbërëse të CAMELS, kryesisht në kahun negativ.

¹⁸ Në SPH të ndërtuar për banka individuale kufiri i këtij treguesi që paralajmëron rrezik për bankën është 70 për qind.

¹⁹ Në vijim, institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë (IFL).

Nëse analizojmë bankat të cilat kanë pësuar ulje të renditjes së përgjithshme të tyre, vërejmë se kjo ulje ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e evidentimit të disa problemeve që mund të kenë ekzistuar edhe më parë. Ky është një tregues i forcimit të funksionit mbikëqyrës, por në të njëjtën kohë tregon se në disa banka, administrimi nuk ka patur orientimin dhe angazhimin e duhur për të identifikuar dhe për të korrigjuar pikat e dobëta të veprimtarisë së institucioneve që drejtojnë si edhe nuk kanë vlerësuar me seriozitetin e duhur rekomandimet e dhëna nga Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2003, bankat janë treguar aktive në zgjerimin e rrjetit të tyre dhe të ativitetit, nëpërmjet hapjes së degëve të reja. Në të njëjtën kohë, ka patur zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit cilësor të shërbimeve bankare dhe nëpërmjet prezantimit e futjes në përdorim të produkteve të reja. Efektet pozitive të këtyre zhvillimeve pritet të jenë edhe më të ndjeshme në të ardhmen e afërt në kushtet e rritjes së treguesve të konkurrencës në treg.

Në mënyrë të përgjithshme, për ecurinë e aktivitetit bankar gjatë vitit 2003 mund të jepen këto vlerësime:

- Të ardhurat e sistemit bankar kanë njohur rritje, duke u mbështetur më shumë në aktivitetet e bankës që përfaqësojnë burime të qëndrueshme të gjenerimit të tyre.
- Aktivitetet e sistemit bankar kanë shënuar rritje, duke qenë kryesisht tregues i afrimit të publikut pranë tyre dhe i aftësisë për të gjetur mënyra të përdorimit të burimeve financiare. Kjo rritje është ndihmuar nga një politikë marketingu më agresive nga ana e bankave, nga zgjerimi me degë dhe agjenci të reja si edhe nga mbështetja në shkallën e nevojshme me infrastrukturën teknike, rregullative si edhe njerëzore.
- Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për të gjitha bankat është mbi nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë. Në disa banka, ky tregues është mjaft i lartë duke folur për një politikë konservatore dhe një mungesë efektiviteti në veprimtarinë bankare. Aksionerët e bankave kanë treguar gatishmëri për të shtuar kapitalin në bankë kur ka qenë e nevojshme²⁰, por reagimi i tyre duhet të jetë shumë më i shpejtë dhe më i qëndrueshëm në kohë. Gjykojmë që administrimi i bankave, duhet të bëjë një punë më të madhe për njohjen e aksionerëve me kuadrin përkatës rregullativ dhe rëndësinë e zbatimit të plotë të tij.
- Administratorët e bankave, në përgjithësi kanë reaguar pozitivisht dhe me përgjegjshmëri ndaj vërejtjeve dhe rekomandimeve të ngritura në raportet e inspektimit. Megjithatë, në disa raste janë evidentuar reagime të pamjaftueshme ose dobësi në drejtim të përmbushjes me rigorozitet të rekomandimeve apo urdhërave të Bankës së Shqipërisë, në mbështetje të kuadrit ligjor dhe rregullativ të Bankës së Shqipërisë dhe parimeve për kryerjen e aktivitetit bankar në mënyrë të sigurtë.

Në mënyrë të detajuar, bankat kanë shfaqur probleme në drejtimet e mëposhtme:

- Zbatimin me rigorozitet të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” lidhur me ekzistencën dhe mirëfunksionimin e komitetit të kontrollit, me përdorimin e gjuhës shqipe; me emërimin në funksione drejtuese të individëve që i plotësojnë kërkesat; me plotësimin e dosjeve të kredisë me të gjithë dokumentacionin e kërkuar etj..
- Respektimin e rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Në disa banka, është vënë re se nuk është bërë klasifikimi i drejtë i kredive me probleme në përputhje me këtë rregullore, dhe si rrjedhojë nuk është krijuar dhe fondi i nevojshëm për provigjone.

²⁰ Për plotësimin e kapitalit, në rastet kur kapitali bazë ka qenë nën nivelin e kapitalit minimal të paguar, sipas nivelit të dhënë të licencës.

- Respektimin e rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për veprimtarinë valutore”, në lidhje me dokumentacionin përkatës që duhet të shoqërojë transfertat e kryera nga banka.
- Plotësimin dhe përmirësimin e politikave dhe procedurave të aktivitetit të bankës.
- Funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm dhe forcimin e pavarësisë së tij.
- Përmirësimin e elementeve të sigurisë në trajtimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, lidhur me shtimin e masave mbrojtëse për parandalimin e ndërhyrjeve nga jashtë, të instalimit të *Firewall* për kontrollimin dhe për filtrimin e trafikut të informacionit, të aplikimit të enkriptimeve për informacionin jo vetëm gjatë transmetimit por edhe gjatë kryerjes së *back-up*, të kryerjes së *back-up* me frekuencën e nevojshme, të hartimit dhe të zbatimit të një plani rikuperimi në rastet e situatave të jashtëzakonshme etj..
- Zbatimin me rigorozitet të kuadrit rregullator për parandalimin e pastrimit të parave.

Për problemet e mësipërme të identifikuara kryesisht gjatë inspektimeve, Banka e Shqipërisë ka bërë rekomandimet përkatëse për çdo bankë në veçanti, duke përcaktuar afate konkrete për plotësimin e tyre. Disa herë janë marrë masa administrative ndaj bankave, për mosreagimin e duhur dhe për mosplotësimin ose mosadresimin në kohë të mangësive të identifikuara. Megjithë përmirësimet, duhet të forcohen kapacitetet në drejtim të ndjekjes së rekomandimeve dhe të zbatimit të tyre në banka, nga ana e mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2003, mendojmë se është përmirësuar cilësia e inspektimeve si edhe hartimi i raporteve të inspektimit, nëpërmjet forcimit të hierarkisë dhe rritjes së përgjegjshmërisë jo vetëm brenda Zyrës së Inspektimeve në Vend por edhe në Departamentin e Mbikëqyrjes në tërësi. Gjetjet e inspektimit dhe projektraportet janë diskutuar intensivisht jo vetëm brenda grupit të inspektimit, si pjesë edhe e trajnimit në procesin e punës, por edhe me drejtuesit e njësisë dhe drejtuesit e departamentit, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Gjithashtu, në procesin e inspektimit, i është kushtuar vëmendje më e madhe bashkëpunimit me ekspertët kontabël të autorizuar, në aspektin e njohjes më në thellësi të raporteve të tyre për banka të ndryshme dhe veçanërisht të gjetjeve që trajtohen në letrën e menaxhimit. Për vitin në vijim, ky bashkëpunim do të konkretizohet me hartimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me këto institucione, si edhe me diskutime të paracaktuara apo të rastit për probleme të ndryshme që shqetësojnë të dyja palët.

I një rëndësie parësore në procesin e mbikëqyrjes së bankës, në inspektimin dhe ndjekjen e rekomandimeve pranë çdo banke, është bashkëpunimi midis të gjitha strukturave të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe veçanërisht midis Zyrës së Inspektimeve në Vend dhe Zyrës së Analizave dhe të Mbikëqyrjes nga Jashtë. Megjithëse bashkëpunimi ekziston, mendojmë se ka hapësira për të përmirësuar cilësinë e shkëmbimit të informacionit dhe të debatit, që duhet të karakterizojë këtë bashkëpunim.

Gjatë vitit të kaluar, vëmendje më e madhe iu kushtua forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në Departamentin e Mbikëqyrjes. Si tregues i këtij kujdesi në rritje është kalimi i departamentit në varësinë e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, ndryshimi i strukturës dhe shtimi i numrit të personelit, hartimi i politikave të brendshme të trainimit etj.. Ne besojmë se gradualisht, këto masa do të japin efektin e tyre në përmirësimin e përgjithshëm të funksionit mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2.8. Ndryshimet dhe zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ

2.8.1 Rregullimet

Ndryshimet e kryera në këtë drejtim, kanë synuar përmirësimin e kuadrit rregullativ ekzistues në drejtim të zbatimit të parimeve të Bazelit për një mbikëqyrje efektive dhe në zbatim të Planit të Zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes të hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Ndryshime, me qëllim përmirësimin e tyre, kanë ndodhur në këto akte rregullative:

- Rregullorja **“Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave”** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.06, datë 29.01.2003, u ndryshua me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 102, datë 10.12.2003. Këto ndryshime kanë për qëllim rritjen e rolit të Komitetit të Kontrollit lidhur me përzgjedhjen e ekspertit kontabël të autorizuar dhe vlerësimin e raportit të tij, përcaktimin e kompetencave për miratimin dhe refuzimin e ekspertit kontabël të autorizuar nga ana e Bankës së Shqipërisë, krijimin e mundësisë që Banka e Shqipërisë të kërkojë nga eksperti kontabël i autorizuar, auditimin dhe vlerësimin e drejtimeve të veçanta të veprimtarisë së bankës ku vëren parregullsi apo rrezik më të madh, si dhe kërkesa e plotësimit në çdo rast nga eksperti i “Iletrës për administratorët”, e cila i dorëzohet edhe inspektorëve të mbikëqyrjes bankare.
- Udhëzimi **“Për likuiditetin e bankave”**, ku ndryshimet kanë synuar rritjen e fleksibilitetit për bankat në mënyrë që të llogarisin raporte shtesë të likuiditetit si dhe saktësimin e përcaktimit të aktiveve likuide.
- Rregullorja **“Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit”**, ku ndryshimet u imponuan për t’i paraprirë tendencës së re të institucioneve të mikrofinancës, për konsolidim ose transformim nëpërmjet bashkimit. Këto ndryshime parashikojnë procedura licencimi në rastin e bashkimit të shoqërive të kursim-kreditit, duke krijuar një shoqëri të re ose vazhdim të veprimtarisë në një formë të zgjeruar në rastin e thithjes së një shoqërie nga një tjetër.
- Rregullorja **“Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë”**, ku ndryshimet kanë përmirësuar përcaktimet lidhur me dokumentacionin dhe me mënyrën e plotësimit të tij, si edhe kanë saktësuar përcaktimet për kapitalin e paguar, kur subjekti kërkon të kryejë më shumë se një veprimtari të lejuar. Në të njëjtën kohë, ndryshimet kanë synuar sjelljen në harmoni të kësaj rregulloreje me rregulloren “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregullorja **“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”**, ku ndryshimi kishte për qëllim që të gjitha kreditë e garantuara nga EX-IM Bank e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfshiheshin në mënyrë eksplicite në zërat e bilancit të ponderuar me koeficient zero për qind, për qëllime të mjaftueshmërisë së kapitalit.
- Rregullorja **“Për veprimtarinë valutore”**, ku ndryshimet kishin për qëllim liberalizimin gradual të veprimeve me llogarinë kapitale, duke evoluuar në këtë mënyrë në drejtim të plotësimit të detyrimeve të rrjedhura nga anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë, si dhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian. Pjesa thelbësore e ndryshimeve ka të bëjë me heqjen e kufizimit të miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë për veprimet në llogarinë korrente mbi një kufi të caktuar si dhe për veprimet në llogarinë e kapitalit, dhe kalimi i të drejtës për verifikimin e dokumentacionit në këtë rast nga vetë bankat. Ndryshimet përfshinin gjithashtu, saktësimin e dokumentacionit që duhet plotësuar në kryerjen e veprimeve, si edhe qartësimin e disa veprimeve të kërkuara nga rregullorja, mbështetur në zbatimin e saj në praktikë.
- Rregullorja **“Për licencimin e zyrave të këmbimit valutore”**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 30.07.2003, e cila ka rrjedhur nga udhëzimi i mëparshëm i përfshirë në rregulloren e vjetër “Për veprimtarinë valutore”. Ndryshimet në këtë rast, kanë synuar disa saktësime lidhur me përpunimin dhe me plotësimin e dokumentacionit. Në të njëjtën kohë, është parashikuar që në inspektimin e ambienteve të zyrave të këmbimit valutore, si pjesë e procesit të dhënies së licencës, do të angazhohet edhe një specialist i Sektorit të Sigurimit të Bankës së Shqipërisë.

- Udhëzimi “**Për raportimin e veprimeve të këmbimit valutor**”, ku për qëllime analitike dhe statistikore, nga operatorët e tregut valutor, bankat dhe zyrat e këmbimit kërkohet raportimi në Bankën e Shqipërisë lidhur me veprimet e tyre në monedhë të huaj. Për këtë qëllim është miratuar një sistem raportimi i përbërë nga disa formularë ku përcaktohen dhe afatet e raportimit të tij.
- Rregullorja “**Për administratorët e bankave**”, ku ndryshimet kishin për qëllim përcaktimin e administratorëve si subjekt i kërkesave të rregullores, për të cilët kërkohet paraprakisht miratimi i Bankës së Shqipërisë për emërimin e tyre. Në ndryshim nga rregullorja e mëparshme, këtu saktësohen kërkesat lidhur me reputacionin, me edukimin dhe me përvojën e kërkuar për personat që do të jenë administratorë të bankës apo të degës së bankës së huaj. Kjo rregullore zgjidh edhe problemin e organeve vendimmarrëse dhe kontrolluese për degën e një banke të huaj. Gjithashtu, për efekt të ruajtjes së pavarësisë vendimmarrëse dhe kontrolluese të organeve të ndryshme të bankës, vendosen disa kufizime lidhur me qenien si administratorë në dy ose më shumë organe drejtuese dhe kontrolluese të bankës.
- Rregullorja “**Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të**”, e cila është hartuar në plotësim të kuadrit rregullativ. Qëllimi i hartimit të kësaj rregullorje është reduktimi i rrezikut të bankës si rezultat i kryerjes së veprimeve me persona të lidhur. Përcaktimi në këtë rregullore merr në konsideratë raportet me personat e lidhur për efekt të pronësisë si dhe me administratorët e saj. Në këtë rregullore përcaktohen edhe kufijtë e këtyre raporteve lidhur me dhënien e kredisë si edhe për transaksione të tjera. Personat e lidhur midis tyre konsiderohen si një kundërparti e vetme dhe për efekt kujdesi, koeficienti i ponderimit për ta njehsohet me koeficientin më të madh të secilit prej tyre. Rregullorja përcakton normat e mbikëqyrjes për personat e lidhur si dhe bën diferencimin e rastit kur personi i lidhur është një bankë. Këto norma janë përshtatur me normat e mbikëqyrjes për rreziqet e mëdha.

2.8.2 Licencimi

Nga viti në vit, numri i subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë vjen duke u rritur. Gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë miratoi dhënien e licencës për të ushtruar aktivitetin bankar bankës “Credins” sh.a. e cila është banka e parë e krijuar nga persona juridikë dhe individë shqiptarë, një bankë me kapital privat vendas. Banka u krijua me kapitalin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer aktivitet bankar dhe është licencuar për të kryer aktivitet bankar sipas nivelit të parë të licencës.

Ky zhvillim u pasua nga kërkesa e një grupi tjetër sipërmarrësish shqiptarë për të krijuar një bankë me kapital privat shqiptar. Pas shqyrtimit të aplikimit të paraqitur nga 23 aksionerë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë konkludoi në miratim për dhënien e licencës paraprake “Bankës Popullore sh.a”.

Gjatë këtij viti Banka e Shqipërisë dha lejen për hapjen e një dege jashtë vendit, kërkuar nga Banka Amerikane e Shqipërisë në funksion të synimit për marrjen e licencës për hapjen e një dege të bankës në Athinë, Greqi. Ndërsa Bankës së Kursimeve iu dha miratimi për hapjen e një dege të saj në Prishtinë.

Po kështu, u shtua numri i subjekteve jobanka me dy subjekte të reja: “Albacredit sh.p.k”, licencuar për të ushtruar veprimtaritë e shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve dhe të ndërmjetësimin në transaksionet monetare (duke përfshirë valutat), dhe “AK- Invest sh.a.”, licencuar për të ushtruar veprimtaritë e shërbimit të pagesave dhe arkëtimeve; të ndërmjetësimin në transaksionet monetare (duke përfshirë valutat) si edhe të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Numri i shoqërive të kursim-kreditit, të licencuara nga Banka e Shqipërisë u shtua me 20 shoqëri të reja, të cilat janë anëtare përkatësisht të dy unioneve ekzistuese të shoqërive të kursim-

kreditit, “Jehona” dhe “Unioni Shqipar i Shoqërive të Kursim-Kreditit”. Njëkohësisht, iu revokua licenca një shoqërie e cila u krijua si një shoqëri e veçantë e papërfshirë në unione, pasi kjo shoqëri sipas grupit të inspektimit rezultoi se nuk zhvillonte aktivitetin për të cilin ishte licencuar. Në fund të vitit 2003 ka filluar dhe fenomeni i bashkimit të shoqërive të kursim- kreditit me njëra-tjetrën.

Numri i zyrave të këmbimit valutor të licencuara gjatë vitit 2003 ka qenë i reduktuar, krahasuar me vitin 2002 gjatë të cilit u licencuan 20 zyra të këmbimeve valutore, si pasojë e disa veprimeve administrative të shtetit ndaj subjekteve që vepronin pa licencë në tregun joformal. Gjatë këtij viti, u licencuan 3 zyra të reja këmbimi valutor, iu revokua licenca 3 zyrave të tjera dhe u mbyll një agjenci e një zyre të këmbimit valutor që kishte dy të tilla.

Për herë të parë gjatë vitit 2003, në zbatim të rregullores “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”, iu dha licenca e parë për hapjen e një zyre përfaqësimi në Tiranë një banke të huaj, Bankës Popullore Pulieze. Kjo zyrë përfaqësimi ka për qëllim studimin e tregut si dhe përgatitjen për hapjen e një banke ose të një dege të kësaj banke në një periudhë të mëvonshme. Sipas licencës, asaj nuk i lejohet të kryejë aktivitet bankar dhe financiar.

Tabela 10. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë

Nr.	Subjektet	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7
3	Zyra të këmbimit valuator	19	38	57	57
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2

Gjatë vitit 2003 është dhënë miratimi për ndryshime të emrave të disa bankave. Kështu, Banka Arabo-Shqiptare Islamike e ndryshon emrin e saj në Banka e Bashkuar e Shqipërisë, banka Fefad e ndryshon emrin e saj në banka “ProCredit”, dhe banka Tregtare e Greqisë (Shqipëri) e ndryshon emrin e saj në banka EMPORIKI (që është akoma në proces).

Për herë të parë gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë, miratoi “Parimet e licencimit të bankave” si një dokument i rëndësishëm lidhur me procesin e licencimit të bankave. Ky dokument përcakton parimet kryesore të këtij procesi, ku përfshihen e drejta e barabartë për aplikim, trajtimi i barabartë i aplikimeve, ruajtja e besimit të publikut, mbrojtja e konkurrencës, transparenca e procesit të licencimit dhe e vendimmarrjes etj..

3. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME

3.1 Privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe pritshmëria

Procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve, është intensifikuar me përgatitjen dhe zbatimin e një plani veprimesh për ristrukturimin e bankës, gjatë periudhës dhjetor 2002 – shtator 2003, të hartuar nga Ministria e Financave.

Ky plan konsistonte në zhvillimin e mëtejshëm të informatizimit dhe telekomunikacionit në bankë, në reduktimin dhe në përmirësimin cilësor të personelit, në transferimin e shërbimeve fiskale, në ristrukturimin e rrjetit të bankës, në përmirësimin e sistemit të pagesave, në shtrirjen rajonale të bankës, në reduktimin e mbizotërimit të bankës në treg dhe në kryerjen e një marketingu më të mirë për veprimtarinë e bankës.

Departamenti i Mbikëqyrjes, në procesin mbikëqyrës ka ndjekur edhe zbatimin e këtij plani dhe ka konstatuar se ai është ndjekur me vëmendjen e duhur nga Banka e Kursimeve dhe strukturat drejtuese të saj.

Në funksion të procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe të realizimit të objektivit kryesor të mbikëqyrjes: ruajtjes dhe stabilitetit të sistemit financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes kontribuoi në fushatën e ndërmarë nga Banka e Shqipërisë për sensibilizimin e publikut për rëndësinë e privatizimit të Bankës së Kursimeve, në drejtim të sigurisë dhe prosperitetit të saj dhe të sistemit bankar në tërësi, në të ardhmen. Ky qëllim u realizua nëpërmjet kontakteve direkte me mediat si edhe botimit të artikujve të ndryshëm në shtypin e shkruar.

Në përfundim të procesit të sipërpërmendur, në fund të vitit 2003, me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Banka e Kursimeve u privatizua në masen 100 për qind të vlerës së aksioneve të saj. Aksioneri i ri dhe i vetëm i bankës, Raiffeisen zentralbank, Austri, një grup financiar i njohur në Bashkimin Evropian dhe me investime të rëndësishme në sektorin bankar të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Aksioneri i ri, pritet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për vazhdimin e ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, me ndikim në drejtim të përsosjes së infrastrukturës bankare në përgjithësi.

Pritshmëria

Privatizimi i Bankës së Kursimeve mendohet të ketë efekte të rëndësishme në sektorin bankar në Shqipëri. Së pari, aksioneri i ri pritet të nisë aktivitetin kreditues, prej të cilit Banka e Kursimeve ishte kufizuar, përse kohë ajo ishte një bankë me kapital shtetëror. Angazhimi në aktivitetin kreditues do të jetë në funksion të ngritjes dhe të organizimit të strukturave të nevojshme brenda bankës për kryerjen dhe monitorimin e këtij aktiviteti, si edhe njohjen e tregut në përgjithësi. Banka mund të orientojë kreditimin e saj, duke i dhënë një përmasë të rëndësishme kreditimit në lekë. Ky mund të jetë një zhvillim i imponuar nga struktura e burimeve të saj, si edhe një mundësi e bankës për të lëvizur më shpejt drejt një drejtimi kreditimi, i cili deri tani nuk është shfrytëzuar në potencialet e tij.

Me çlirimin e fondeve të konsiderueshme drejt kreditimit, do të rriten kapacitetet e sistemit bankar për t'i ofruar këtë shërbim klienteles, por njëkohësisht do të rritet ndjeshëm edhe konkurrenca në treg. Disa banka, mund ta provojnë konkurrencën në formën e uljes së marzhit të tyre të interesave dhe të fitimit, ndërsa disa të tjera mund të konstatojnë largim të klientelës. Ky presion në rritje, në ato banka ku sistemet e kontrollit dhe kuadri i politikave dhe i procedurave kanë ende nevojë për përmirësim, mund të shoqërohet me rritjen e rrezikut që bankat do të jenë të gatshme të sipërmarrin, duke kërkuar në këtë mënyrë një mbikëqyrje më të afërt dhe më të kujdesshme.

Kalimi gradual drejt kreditimit, nuk pritet të sjellë presione të ndjeshme mbi normat e interesit të bonove të thesarit, në kushtet kur aksioneri i ri i Bankës së Kursimeve, pritet të tregojë kujdesin e duhur në administrimin e portofolit të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të cilat i zotëron.

Aksioneri i ri pritet të sjellë përvojën e tij në zhvillimin në treg të produkteve të reja, të cilat lidhen kryesisht me instrumentet e pagesave për klientët. Banka të tjera të cilat nuk janë aktive në këtë drejtim, pritet të ndjekin këto zhvillime dhe të ndërtojnë strategjitë e tyre respektive.

Origjina nga një vend anëtar i Bashkimit Evropian, do të ketë ndikimin e saj në sjelljen në treg të një mentaliteti të ri në administrimin e bankave, pra në të ashtuquajturën *corporate governance*. Institucione të këtyre përmasave, vendosin kudo që shkojnë, një organizim të tillë të punës, i cili synon aplikimin e standardeve më të mira në investimet e reja. Politikat e vendimmarrjes, të transparencës, të organizimit të personelit etj., synojnë krijimin e një sipërmarrjeje eficiente dhe që ngjall besim te klientët. Këto tipare pritet të evidentohen shpejt edhe në Bankën e Kursimeve dhe nëpërmjet saj në të gjithë sistemin bankar. Në të njëjtën kohë, aksioneri i ri sjell me vete kulturën dhe detyrimin e zbatimit të parimeve ndërkombëtare më të mira në drejtim të standardeve

ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të auditimit. Këto janë të detyrueshme për t'u zbatuar, sipas Direktivave të Bashkimit Evropian. Do të jetë një përvojë shumë e mirë për të gjithë sistemin bankar në Shqipëri dhe të gjithë aktorët e tjerë të sferës financiare, në kushtet kur synimi i përbashkët është aplikimi i këtyre standardeve në një kohë sa më të shpejtë.

Privatizimi i Bankës së Kursimeve do të ndikojë edhe mbi mënyrën e realizimit të politikës monetare nga Banka e Shqipërisë, veçanërisht nëpërmjet forcimit të një kanali të rëndësishëm të transmissioinit monetar (kreditimit). Përveç kësaj, shndërrohet në domosdoshmëri nevoja që vendimet në sferën e politikës monetare të jenë reflektim sa më i gjerë i pritjeve të sistemit bankar dhe aktorëve të tij më të rëndësishëm, ndaj zhvillimeve makroekonomike. Vetëm kështu, vendimet që merren mund të jenë plotësisht efektive. Deri tani, përpjekjet që bën Banka e Shqipërisë për përfshirjen e opinioneve të bankave të nivelit të dytë në vendimet e saj, si edhe për orientimin e tyre në përputhje me objektivat makroekonomikë, janë të konsiderueshme, por angazhimi i bankave në këtë drejtim, ndonëse ka ardhur në rritje, mund të ishte edhe më i madh.

Ndikime të rëndësishme priten të vihen re edhe në drejtim të diskutimit teorik dhe të kërkimit mbi fenomenet financiare që mund të ndikojnë në ecurinë e sistemit bankar dhe të tregut financiar në përgjithësi. Institucione të këtyre përmasave nuk mund të jenë pasive ndaj ngjarjeve ekonomike. Përkundrazi, ato përpiqen t'i parashikojnë ato dhe t'iu paraprijnë me veprimet e nevojshme. Është kjo arsyeja që investimet e tyre në drejtim të fushës kërkimore janë të konsiderueshme. Sot në botë, institucionet financiare dhe bizneset e mëdha private, ofrojnë mendimin më të kualifikuar ekonomik dhe shpesh përcaktojnë tendencat nëpër të cilat kalon ekonomia e një vendi. Ky do të ishte një element shumë i dobishëm për sistemin tonë bankar, ku oponenta publike e sektorit privat të biznesit dhe të bankave ndaj vendimeve ekonomike, ose puna kërkimore ndaj tendencave dhe fenomeneve të sistemit tonë financiar, duhet të jenë shumë më aktive. Kontributi në sferën kërkimore dhe në studimin e fenomeneve nga ana e Bankës së Kursimeve (tani, e privatizuar), pritet të ndikojë edhe në rritjen e transparencës për zhvillimet ekonomike në vend, ndaj qarqeve kërkimore-ekonomike rajonale dhe evropiane. Kjo pasi, grupe të tilla të fuqishme financiare, zotërojnë infrastrukturën e nevojshme për paraqitjen e të dhënave të ndryshme ekonomike dhe ndërtimin e opinioneve të tregut rreth tyre.

Privatizimi i Bankës së Kursimeve mund të konsiderohet i suksesshëm edhe për faktin që ai mund të shoqërohet me afrimin në ekonominë shqiptare të investitorëve të huaj të rëndësishëm. Kjo është një praktikë e njohur, ku hyrja në një treg nga një institucion financiar i njohur shërben si një katalizator për kthimin e vëmendjes drejt këtij tregu edhe nga investitorë të tjerë. Efektet në këtë rast do të ishin mjaft pozitive dhe nuk do të kishte nevojë për komente të zgjatura. Banka e Kursimeve do të jetë tashmë tërësisht e integruar në tregun ndërkombëtar, në kushtet kur pronari i saj përfaqëson një bankë, grup financiar me interesa universale.

Ne mendojmë së privatizimi i Bankës së Kursimeve, e ngre cilësinë e sistemit tonë bankar në një nivel më të lartë. Ai përfaqëson në të njëjtën kohë një sfidë të rëndësishme për funksionin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, veçanërisht në kushtet kur produktet dhe instrumentet që do të përdoren nga bankat do të shtohen dhe do të ndërlikohen. Do të nevojitet në këtë mënyrë, përmirësimi i përbërjes, rritja cilësore e stafit, rritja e mundësive të trainimit, vendosja e lidhjeve të ngushta me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të huaja prej nga vijnë institucionet financiare, zbatimi i parimeve të mbikëqyrjes së konsoliduar etj.. Bashkëpunimi në këto kushte me autoritetet mbikëqyrëse të institucioneve të tjera financiare që operojnë në vendin tonë (për shembull, kompanitë e sigurimit), shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar etj., është një domosdoshmëri.

3.2 Parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

Viti 2003, ka shënuar disa zhvillime të rëndësishme në këtë drejtim, ku më kryesori është ndryshimi i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” si edhe ndryshimet e tjera në “Kodin penal” dhe në “Kodin e procedurës penale”. Ndryshimet synonin kryesisht zgjerimin e subjekteve që i nënshtrohen ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” si edhe në përcaktimin e veprimtarisë së pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit si një vepër penale. Në vijim, përcaktohet detyrimi për konfiskimin e mjeteve dhe të produkteve që financojnë ose rrjedhin nga kjo vepër penale.

Në mënyrë më të detajuar, ndryshimi i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, konsiston në:

- përcaktimin më të qartë të termit “pastrim i parave”;
- shtimin e subjekteve të ligjit, duke përfshirë agjencitë jofitimprurëse, shoqëritë e ndërtimit, agjencitë e udhëtimit, organizatat joqeveritare, bursën, Agjencinë Kombëtare të Privatizimit etj.;
- zvogëlimin e shumës kufi të transaksionit që duhet raportuar pranë Autoritetit Përgjegjës nga 70 milionë lekë në 20 milionë lekë;
- vendosjen e një kufiri më të ulët prej 200 mijë lekësh për transaksionet e subjekteve të tilla si agjencitë e udhëtimit, shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e lojrave të fatit;
- shtimin e një sërë masash parandaluese;
- detajimin e raportimeve të organeve doganore si dhe të veprimtarive bankare dhe financiare;
- etj..

Ndryshimi i ligjit, diktoi ndryshime në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Përveç ndryshimeve të ligjit, ndryshimet në rregullore u mbështetën edhe në vërejtjet e Grupit të Ekspertëve të Komisionit Evropian për luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit, 40 rekomandimet e Financial Action Task Force (FATF) si dhe 8 rekomandimet e shtuara aktualisht për efekt të luftës kundër terrorizmit, si edhe në direktivën e Këshillit të Evropës, nr.2001/97EC, ndryshuar me direktivën nr. 91/308/EEC “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave”. Për ndryshimin e rregullores, u shfrytëzua edhe asistenca e huaj e ofruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Kjo rregullore, në ndryshim nga udhëzimi i mëparshëm, përcakton më mirë:

- rastet kur bëhet identifikimi i klientit;
- llojet e dokumenteve që duhet të paraqesë në çdo rast klienti në bankë për identifikim;
- mënyrën e administrimit të dokumentacionit. Në bazë të ligjit, identifikimi bëhet me dokumentacionin origjinal, ndërkohë që në rregullore është saktësuar që këto dokumente fotokopjohen nga banka, vulosen prej saj dhe mbahen në dosjen e klientit;
- rastet e veprimit me llogari elektronike (e-banking account);
- si vepron banka kur identifikon një transaksion të dyshimtë;
- procedurat e brendshme të bankës të miratuara nga këshilli drejtues lidhur me parandalimin e pastrimit të parave;
- rolin e Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës për parandalimin e pastrimit të parave;
- kërkesën që raportet për transaksione të dyshimta të dërgohen jo vetëm tek autoriteti përgjegjës por edhe në Bankën e Shqipërisë;
- janë bërë disa shtesa tek aneksi 1 i rregullores duke përfshirë edhe aktivitete të tjera të papërfshira më parë;
- është shtuar një aneks i ri (aneksi 2) duke listuar të gjitha llojet e transaksioneve për të cilat bankat duhet të njoftojnë autoritetin përgjegjës, etj..

Krahas ndryshimeve ligjore dhe rregullative, ka patur përparime edhe në drejtim të konceptimit të procesit në tërësi. Ekziston një dialog më i mirë midis Drejtorisë së Luftës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe institucioneve të tjera, të cilat veprojnë në rolin e autoritetit mbikëqyrës për subjektet e ligjit. Është rritur gjithashtu, bashkëpunimi midis vetë autoriteteve mbikëqyrëse. Janë organizuar mjaft takime të përbashkëta si edhe trainime, në të cilat është synuar sqarimi i përgjegjësive si edhe është realizuar shkëmbimi i përvojës. Është shkëmbyer informacion për subjekte të veçanta të ligjit.

Megjithatë, mendojmë se ka ende mjaft për të bërë në këtë drejtim. Nevojitet një dialog më i qëndrueshëm dhe më konkret midis autoritetit përgjegjës dhe autoriteteve mbikëqyrëse me subjektet e ligjit. Kjo kërkesë paraqitet veçanërisht e vërtetë në rastin e bankave, të cilat përfaqësojnë subjektet e ligjit me sasinë dhe cilësinë më të mirë të raportimit dhe të bashkëpunimit në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave. Bankat kërkojnë një nivel më të madh të pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjen që lidhet me përcaktimin e kuadrit rregullativ të parandalimit të pastrimit të parave, procedura më të sakta dhe plotësisht të zbatueshme në ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit që shkëmbehet etj..

Në zbatim të kërkesave të ligjit, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes, ka ushtruar kontrolle mbi subjektet e licencuara prej saj në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave. Këto kontrolle, janë pjesë e inspektimeve të përgjithshme në banka dhe në institucione të tjera të licencuara, ose janë konceptuar si inspektime specifike. Gjatë tyre, është parë përputhëria e aktivitetit të bankës me kërkesat e akteve ligjore dhe rregullative përkatëse, është vlerësuar mjaftueshmëria e strukturës së bankës që ndjek parandalimin e pastrimit të parave, janë verifikuar praktika të ndryshme të pagesave dhe të arkëtimit, është parë mënyra e raportimit të subjektit pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave si autoriteti përgjegjës etj.. Në rastet kur gjetjet janë thelbësore, ato i bëhen të ditura autoritetit përgjegjës dhe për bankën përcaktohen rekomandime të veçanta. Përgjithësisht, situata paraqitet e mirë, por janë konstatuar parregullsi në drejtim të:

- raportimit të plotë pranë autoritetit përgjegjës;
- plotësisht të saktë të formularëve përkatës;
- përcaktimit të saktë të procedurave të brendshme të subjektit lidhur me hartimin e rregulloreve përkatëse ose me caktimin e personave përgjegjës me hierarkinë e nevojshme.

Pavarësisht nga kjo, përgjithësisht viti 2003 ka shënuar një kuptim më të mirë të domosdoshmërisë për zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

3.3 Plani i Zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes

Që prej fillimit të vitit 2001, Departamenti i Mbikëqyrjes është i angazhuar në zbatimin e një plani zhvillimi, i cili është hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Qëllimi kryesor i këtij plani zhvillimi është standardizimi i procesit mbikëqyrës dhe i procedurave të tij, shndërrimi i mbikëqyrjes në një proces të vazhdueshëm dhe proaktiv, si edhe orientimi i tij drejt identifikimit të rreziqeve, drejt zbatimit të masave korrektuese dhe drejt verifikimit të zbatueshmërisë së tyre.

Elementet e këtij plani, janë të shtrira në katër drejtime kryesore që ndërveprojnë mes tyre, ku përmendim: përmirësimin e vendimmarrjes; transparencën dhe komunikimin; rishikimin e kuadrit rregullativ; si edhe implementimin e instrumenteve të nevojshme për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Në lidhje me përmirësimin në vendimmarrje, disa nga hapat që janë ndërmarrë lidhen me:

- përcaktimin e saktë të kompetencave vendimmarrëse, si përsa i takon njësisë përgjegjëse ashtu edhe përsa i takon objektit mbi të cilin ajo merr vendime;
- ndryshimet e nevojshme strukturore, përmirësimin e stafit, përcaktimin e përparësive të trainimit etj.;
- përmirësimin e procesit kërkimor dhe të mbështetjes së nevojshme juridike, të cilat ndikojnë në cilësinë e vendimmarrjes.

Në drejtim të transparencës dhe të komunikimit, mes të tjerash, ky plan synon:

- komunikimin më të mirë brenda departamentit dhe strukturave të Bankës së Shqipërisë për vendimet e ndryshme;
- realizimin e programit vetëkontrollues për njësimin e standardeve mbikëqyrëse të përdorura në inspektimet e bankave të nivelit të dytë;
- vendosjen e një ure të qëndrueshme komunikimi midis mbikëqyrjes bankare dhe industrisë bankare, me qëllim diskutimin e çështjeve që mund të përfaqësojnë një kërcënim për stabilitetin e sistemit bankar në përgjithësi, dhe të bankave të veçanta si edhe për të forcuar kapacitetet në drejtim të identifikimit të problemeve dhe të shkaqeve të ekzistencës së tyre;
- vendosjen e një ure të qëndrueshme komunikimi midis mbikëqyrjes bankare dhe institucioneve të tjera, që kanë funksione mbikëqyrëse dhe audituese në sistemin financiar, brenda dhe jashtë vendit, duke synuar rregullimin e këtij komunikimi me instrumente juridike si edhe duke siguruar shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe hedhjen e hapave të parë drejt mbikëqyrjes së konsoliduar;
- rritjen e transparencës për vendimet mbikëqyrëse, duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë brenda mbikëqyrjes për arsyet që kanë motivuar vendime të caktuara dhe në të njëjtën kohë duke sjellë në vëmendjen e bankave problemet më akute të tyre, të cilat kërkojnë zgjidhje.

Në drejtim të rishikimit të kuadrit rregullativ, nëpërmjet zbatimit të kërkesave të planit të zhvillimit, synohet kryesisht:

- plotësimi i kuadrit rregullativ mbikëqyrës, në kushtet e prezantimit në tregun bankar të produkteve të reja;
- rishikimi i kuadrit rregullativ ekzistues, për të paraqitur ndryshimet e nevojshme në rastet kur ato kërkohen nga niveli në të cilin ka arritur sistemi bankar;
- prezantimi i ndryshimeve të nevojshme rregullative dhe ligjore, për ta sjellë kuadrin tonë rregullativ mbikëqyrës sa më pranë standardeve ndërkombëtare dhe parimeve të Komitetit të Bazelit;
- prezantimi i ndryshimeve të nevojshme në kuadrin rregullativ dhe ligjor mbikëqyrës, për të rritur fleksibilitetin e tij në trajtimin e çështjeve të vecanta mbikëqyrëse si edhe për të saktësuar më mirë trajtimin e problemeve të vecanta dhe përgjegjësitë e secilës palë në zbatimin e tij.

Lidhur me implementimin e instrumenteve të nevojshme për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, është punuar kryesisht në drejtim të:

- saktësimin e procedurave për kryerjen e mbikëqyrjes së bankës, nëpërmjet inspektimeve

- në vend dhe të analizës nga jashtë, si edhe të bashkëpunimit mes njësive që realizojnë mbikëqyrjen;
- përcaktimit të disa dokumenteve si edhe të metodologjisë së ndërtimit të tyre, për të siguruar ndjekjen e bankës në mënyrë të vazhduar si edhe për të orientuar mbikëqyrjen drejt rreziqeve kryesore që ndesh banka;
 - implementimin e këtyre kërkesave në praktikë.

Gjatë vitit 2003, si edhe më parë, Departamenti i Mbikëqyrjes ka qenë i angazhuar në zbatimin e kërkesave të këtij plani. Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së tij, ndërmjet Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Bankës Botërore ka patur një komunikim të vazhdueshëm, i cili është materializuar ndër të tjera edhe nëpërmjet diskutimeve të drejtpërdrejta në kuadrin e misioneve të autorizuara nga Banka Botërore për këtë qëllim. Orientimi i diskutimeve dhe përcaktimi i platformës së mëtejshme për t'u zhvilluar, ka qenë i mbështetur në matricën bazë të planit të punës, me synim edhe për përmirësimin e mëtejshëm cilësor të praktikave, të proceseve, të metodikave dhe të materialeve të formuara ose në formim, që burojnë nga kërkesat e këtij plani.

Ne e konsiderojmë planin e zhvillimit të mbikëqyrjes, si një instrument parësor në përmirësimin cilësor të veprimtarisë mbikëqyrëse. Gjatë vitit 2004, do të punohet për implementimin në praktikë të kërkesave kryesore të tij.

4. ÇËSHTJE QË KËRKOJNË VËMENDJE TË VEÇANTË DHE KONKLUZIONE

Do të veçonim tre drejtime kryesore në të cilat mendojmë se bankat dhe strukturat drejtuese të tyre duhet të ushtrojnë vëmendjen maksimale.

Kreditimi, përfaqëson një drejtim kryesor të aktivitetit bankar, i cili aktualisht ka hyrë në fazën e tij të zgjerimit të qëndrueshëm. Ky zhvillim, është rrjedhojë e krijimit të përvojës së mjaftueshme të bankave në administrimin e këtij aktiviteti bankar, e përmirësimit të situatës sociale në vend, e përmirësimeve legjislative që rregullojnë këtë aktivitet, si edhe e një kulture të përmirësuar të publikut për përfitimin e këtij shërbimi bankar. Por ky drejtim fitimprurës i aktivitetit bankar, përfaqëson njëherazi edhe burimin kryesor të rrezikut të tij, veçanërisht në rastet e përqëndrimit të biznesit bankar drejt këtij aktiviteti.

Ne mendojmë se si rezultat i disa zhvillimeve objektive, niveli i rrezikut në kreditim mund të vijë në rritje. Këto zhvillime objektive përfshijnë forcimin e konkurrencës me privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe angazhimin të saj në kreditim, hapësirave të gjera për rritje të aktivitetit kreditues në të gjithë sistemin bankar, si edhe përqëndrimi i kreditimit në valutë.

Këto zhvillime, mund të shndërrohen në një rrezik real për bankat, nëse strukturat drejtuese të tyre nuk plotësojnë në kohë kuadrin e brendshëm të politikave dhe të procedurave, dhe vonojnë në ngritjen e strukturave të nevojshme të identifikimit dhe të vlerësimit të rrezikut në këtë aktivitet. Në këtë kuadër, ne gjykojmë që bankat duhet:

- të forcojnë me personel dhe infrastrukturë teknologjike, njësitë e strukturës së tyre që janë përgjegjëse për administrimin e procesit të kreditimit;
- t'ia nënshtrojnë procesin e miratimit të kredisë, një diskutimi sa më të gjerë brenda strukturave përkatëse në bankë, duke u treguar të matur në vendimmarrje;
- të përmirësojnë politikat dhe procedurat e tyre të brendshme të administrimit të procesit të kreditimit, duke imponuar lidhjen e kredisë me shërbime të tjera bankare, të cilat e forcojnë lidhjen midis bankës dhe kredimarrësit dhe rrisin shkallën e njohjes së rrezikut të kredisë;
- të forcojnë kërkesat për një ndjekje të afërt të situatës financiare të kredimarrësit, si

- edhe të zbatojnë me rigorozitet kërkesat për një rishikim periodik të cilësisë së portofolit të kredisë duke informuar për këtë strukturat më të larta drejtuese;
- pa cënuar konfidencialitetin e të dhënave, të forcojnë bashkëpunimin mes tyre për shkëmbimin e informacionit lidhur me kredimarrës të caktuar, të cilët janë të pranishëm në disa banka;
 - të vendosin raporte të drejta në përbërjen e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, duke ruajtur diversifikimin e këtij portofoli;
 - të vendosin raporte të drejta midis aktivitetit kreditues dhe drejtimeve të tjera të biznesit bankar, duke ruajtur diversifikimin e biznesit të tyre dhe duke shmangur, sa të jetë e mundur burimet e rrezikut;
 - të respektojnë me rigorozitet, kufijtë për kredinë ndaj një kredimarrësi të vetëm ose grupkredimarrësish të lidhur;
 - të diversifikojnë përbërjen e portofolit të kredisë sipas valutave dhe afateve të maturimit, duke marrë në konsideratë përbërjen dhe strukturën e burimeve të tyre.

Ne besojmë se krijimi i Zyrës së Informacionit të Kredive, qoftë edhe në një nivel jo shumë të avancuar teknologjik, është një nevojë për të cilën sistemi bankar ka kërkesa në rritje. Banka e Shqipërisë, duke inkurajuar dhe duke mbështetur çdo përpjekje në këtë drejtim, mendon se është koha për zhvillime konkrete në implementimin e projekteve që janë sipërmarrë nga Shoqata e Bankave. Nëse ka probleme që vonojnë implementimin, është e nevojshme që ato të bëhen të njohura në mënyrë që bashkërisht të punohet për zgjidhjen e tyre.

Fakti që pjesa mbizotëruese e kredisë së dhënë nga sistemi bankar është në valutë, rrit shqetësimin për ecurinë e kësaj kredie në kushtet e zhvillimeve të pafavorshme në kursin e këmbimit. Respektimi i kufijve për pozicionin e hapur valutor është një instrument mbrojtës për efektet e zhvillimeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, në bilancin e bankave. Megjithatë, rreziku i kursit të këmbimit mund të shoqërohet nga rreziku i kreditit, në rastet kur edhe kredimarrësi e vuan lëvizjen e kursit të këmbimit. Kjo është e vërtetë kur të ardhurat e kredimarrësit gjenerohen në një njësi monetare të ndryshme nga ajo në të cilën është akorduar kredia, e cila nënçmohet. Për këtë arsye, e shohim të nevojshme që banka të forcojë procedurat e saj për thëllimin e analizës financiare të klientit lidhur me burimin dhe me formën e burimit të të ardhurave. Mendojmë, se bankat duhet të krijojnë një bazë të dhënash specifike për këtë qëllim, e cila t'i shërbejë më pas testimit të portofolit të saj të kredisë lidhur me zhvillimet e pafavorshme në kursin e këmbimit. Në të njëjtën kohë, mund të jetë e nevojshme që elemente mbrojtëse lidhur me ruajtjen e vlerës së kredisë në raste të tilla, të parashikohen që në kontratën e kredisë.

Konkurrenca është një tipar i sistemit bankar, i cili pritet të forcohet ndjeshëm me privatizimin e Bankës së Kursimeve, por edhe në sajë të një aktivizimi më të mirë në treg të bankave të tjera private. Disa banka mund ta vuajnë këtë fakt më tepër se të tjerat. Bëhet fjalë për bankat më të vogla, të cilat përpiqen të zgjerojnë pjesën e tyre të tregut. Efektet mund të ndihen edhe në banka më të mëdha, kryesisht në drejtim të lëvizjeve të klientelës. Për t'u mbrojtur nga reduktimi i pjesës së tyre të tregut, disa banka mund të shohin si rrugëzgjdhje zgjerimin e rrjetit të tyre. Nëse këto vendime merren në mënyrë të nxituar, përveç efektit në reduktimin e të ardhurave të aktivitetit në afat të shkurtër, ato mund të rezultojnë edhe në investime joefektive në afat më të gjatë. Banka të tjera, mund të zgjedhin të orientohen drejt aktiviteteve më me rrezik, të cilat sipas tyre, mund t'i ndihmojnë të ruajnë nivelet e marzhit të fitimit dhe të sigurojnë mbarëvajtjen e tyre në të ardhmen. Në të dyja rastet, për një pjesë të bankave mund të kemi reduktim të të ardhurave në afat të shkurtër si edhe rritje të rrezikut të aktivitetit të tyre. Nëse këto fenomene zgjasin në kohë, përveç të tjerave, ky mund të jetë një tregues i "ngopjes" së tregut bankar, ose i ekzistencës së një numri më të madh bankash krahasuar me potencialin për biznes bankar që ofron aktualisht tregu shqiptar. Mendojmë se në këtë rast, duhen marrë në konsideratë edhe mënyra të tjera të forcimit të bankave të veçanta, siç mund të jenë bashkimet mes bankave, blerja e degëve të

veçanta etj.. Në të njëjtën kohë, mund të jetë i nevojshëm shkurajimi i hyrjes në treg të bankave të reja, të cilat nuk pritet të sjellin zhvillime të veçanta pozitive. Si mbikëqyrje, ne do të jemi më pranë bankave të cilat mund të provojnë vështirësi në afatin e shkurtër, për të identifikuar më mirë problemet që ato ndeshin, si edhe për të sugjeruar rrugëzgjdhjet e mundshme.

Elementi i tretë, për të cilin do të kërkonim që strukturat drejtuese të bankës, duke përfshirë këshillin drejtues dhe komitetin e kontrollit, të përqëndronin vemendjen e tyre, është mjaftueshmëria e sistemeve të kontrollit dhe të monitorimit të rrezikut. Është koha që bankat të trajtojnë në mënyrë të shpejtë dhe të zgjidhin përfundimisht disa probleme që mund të ndeshen në drejtim të:

- ndërtimit të një strukture drejtimi dhe operative, e cila siguron plotësisht pavarësinë e strukturës së kontrollit të brendshëm dhe efektivitetin e ushtrimit të funksionit të tij, delegimin e përgjegjësisë sipas aftësive dhe kompetencës dhe shmangien e përqëndrimit të tyre, përcaktimin e elementeve që sigurojnë vendimmarrje të mbështetur dhe përgjegjshmëri e llogaridhënie për këto vendime, respektimin e kërkesave etike në marrëdhëniet me klientët, përcaktimin e halkave që sigurojnë kontrollin e dyfishtë mbi aktivitete delikate të bankave etj.;
- marrëdhënieve me personat e lidhur dhe shmangies së konflikteve të interesit në përzgjedhjen e strukturave drejtuese;
- ngritjes së strukturave të vecanta të monitorimit të rrezikut, veçanërisht në drejtim të aktiviteteve të këmbimeve valutore dhe të investimit të letrave me vlerë. Këtu është e rëndësishme ndarja e funksioneve të realizimit të marrëveshjeve me atë të ekzekutimit të tyre. Veçanërisht i rëndësishëm është kontrolli mbi sistemet e komunikimit si për shembull, Sëift;
- ruajtjes së sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit, nëpërmjet zbatimit të standardeve më të mira të sigurisë, dokumentimit të mënyrës së përdorimit dhe trajtimit ndoshta preferencial të personelit përkatës, duplikimit dhe ruajtjes së të dhënave në vende të sigurta, hartimit të planeve për zhvillimin e biznesit bazë të bankës në kushte të jashtëzakonshme dhe testimin e tyre etj..

Dëshirojmë të theksojmë, se përgjegjësia për realizimin e këtyre kërkesave, është e strukturave më të larta të drejtimit të bankës. Si mbikëqyrje, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë si edhe zbatimit të instrumenteve që na njeh ligji, do të përpiqemi të luajmë rolin tonë në sensibilizimin e strukturave drejtuese të bankave përsa më sipër, si edhe të imponojmë zgjidhjen e tyre.

Në përfundim, mund të konkludojmë që gjendja e sistemit bankar gjatë vitit 2003, u paraqit e qëndrueshme. Rezultati financiar i sistemit ishte pozitiv dhe i rritur në krahasim me vitet e kaluara. Sistemi bankar paraqitet i kapitalizuar mirë, ndërkohë që banka të veçanta kanë provuar rënie të vlerës së kapitalit bazë nën vlerën minimale të kërkuar nga niveli i licencës, kryesisht për shkak të vlerësimit të kursit të këmbimit të lekut dhe pamjaftueshmërisë së të ardhurave të aktivitetit.

Sistemi bankar është mbikëqyrur nga afër nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet departamentit të mbikëqyrjes. Procesi i mbikëqyrjes ka njohur përmirësime, në sajë të një konceptimi më të mirë të bashkëveprimit me industrinë bankare, si edhe të implementimit të disa hapave të përcaktuar në kuadër të planit të zhvillimit të mbikëqyrjes. Megjithatë, nevojitet që këto përpjekje të vazhdojnë për t'u kthyer në një standard të pranuar të mbikëqyrjes.

Vendosja e një ure komunikimi midis industrisë bankare dhe mbikëqyrjes është një element i domosdoshëm, i cili përmirëson funksionin mbikëqyrës duke rritur shkallën e kuptimit të fenomeneve të ndryshme si edhe duke i bërë bankat dhe strukturat e tyre drejtuese më të përgjegjshme për rolin që kanë në zgjidhjen përfundimtare dhe të qëndrueshme të problemeve të ndryshme.

Ky është elementi kryesor ku do të përqëndrohen përpjekjet e Departamentit të Mbikëqyrjes. Ne besojmë se në këtë linjë të rregullt komunikimi do të ketë vend edhe për aktorë të tjerë sic janë shoqëritë e auditimit të jashtëm, institucionet mbikëqyrëse të aktorëve të tjerë të tregut financiar në vend etj..

Më poshtë, kemi menduar të zgjerojmë pjesën e këtij raporti duke bërë një prezantim të shkurtër të Akordit të ri të Bazelit, i cili përfaqëson standardin e ri drejt të cilit po lëviz industria bankare dhe mbikëqyrja. Në vijim, diskutimet rreth kësaj çështje do të shtohen dhe do të pasurohen me kontributin e qenësishëm të industrisë bankare në vend.

5. TË TJERA

5.1. Akordi i ri i Bazelit, vlerësim paraprak.

Akordi i ri Bazelit mbi kapitalin, i njohur ndryshe si Bazell II, është një iniciativë e Komitetit të Bazelit e nisur zyrtarisht në vitin 1999, i cili do të marrë formë përfundimtare gjatë vitit 2004. Kontributi i biznesit bankar në përmirësimin e këtij akordi që prej fillimit të tij, është i konsiderueshëm. Qëllimi i tij kryesor është rikonceptimi i rrezikut në aktivitetin bankar. Në fakt, akordi i ri është një rrjedhojë e përparimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe përdorimit të sistemeve të tilla në vlerësimin e rreziqeve financiare, veçanërisht në bankat dhe grupet financiare më të mëdha në botë.

Akordi i ri, zhvillohet në tre drejtime (shtylla) kryesore:

Shtylla I: Kërkesat minimale për kapital.

Në këtë drejtim, akordi i ri ka disa ndryshime nga akordi ekzistues, kryesisht lidhur me rikonceptimin e rrezikut të kreditit dhe efektet e vlerësimit të tij në mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave, si edhe në prezantimin e një kërkesë shtesë për kapital që i atribuohet vetëm rrezikut operacional.

Në mënyrë më të detajuar, ndryshimet kryesore që lidhen me rrezikun e kreditit, kanë të bëjnë me:

- a) heqjen e konceptit “vend anëtar i OECD dhe vend joanëtar i OECD”, për vlerësimin e rrezikut të kreditit të borxhit të vendeve të ndryshme ose të kompanive që vijnë nga këto vende;
- b) mbështetjen tek agjencitë ndërkombëtare të renditjes si Stabdard&Poor, Moody’s etj., për vlerësimin e rrezikut të kreditit;
- c) prezantimin e një kategorie të re, e cila parashikon ponderimin e disa ekspozimeve për qëllime të vlerësimit të rrezikut të kreditit, me koeficient 150 për qind. Ky element, përfshihet në Metodën e Standardizuar të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, e cila mendohet të jetë e zbatueshme për pjesën më të madhe të bankave. Krahas kësaj metode, akordi i ri iu lejon bankave që të përdorin edhe metodat e tyre të brendshme të vlerësimit të rrezikut të kreditit, përshtatshmëria e të cilave mendohet të jetë subjekt i vlerësimit nga mbikëqyrësit (si pjesë e përcaktimeve në shtyllën e dytë).

Metoda e vlerësimit të rrezikut të kreditit, nëpërmjet sistemeve të brendshme të vlerësimit, është gjykuar e përshtatshme për këto arsye kryesore:

Së pari, procesi i vlerësimit të rrezikut është dinamik, gjithmonë në zhvillim. Për rrjedhojë, akordi i ri ka krijuar hapësirën për adoptimin e ndryshimeve të ardhme, që lidhen me mënyrën e administrimit të rrezikut nga industria bankare. Kështu, bankave u janë dhënë disa mundësi për të llogaritur kërkesat për kapital në varësi të “oreksit” të tyre për rrezik, duke rritur në të njëjtën kohë shkallën e pranimet të akordit.

Së dyti, për të inkurajuar bankat që të zhvillojnë dhe të përsosin teknikat dhe modelet e brendshme të administrimit të rrezikut, në kushtet kur kjo mund të shoqërohet me reduktim të kërkesave të bankës për kapital.

Për këto arsye, kuptohet që metoda e vlerësimit të brendshëm, është më e zbatueshme për një kategori të caktuar bankash, të cilat janë në pararojë të investimeve dhe të përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit, për vlerësimin e rrezikut. Përgjithësisht, këto janë banka të fuqishme dhe aktive në tregjet ndërkombëtare. Metoda standarde, do të jetë e preferuar për një kategori bankash, të cilat janë më pak të përparuara në teknikat e administrimit të rrezikut dhe që janë të detyruara të mbështeten mbi vlerësimet e rrezikut të bëra nga jashtë (për shembull, nga kompanitë e renditjes).

Në lidhje me rrezikun operacional, ndryshimi i prezantuar në akordin e ri lidhet me faktin që kërkesa për kapital për mbulimin e këtij rreziku nuk do të jetë e nënkuptuar (e përfshirë brenda raportit prej 8 për qind të mjaftueshmërisë), por do të jetë e veçantë (shtesë) dhe do të llogaritet sipas njëres prej metodave që ofrohen në paketën rregulluese.

Shtylla 2: Roli mbikëqyrës.

Thelbi i kësaj shtylle qëndron në përgjegjësinë që iu jepet mbikëqyrësve për vlerësimin e përshatshmërisë së modeleve të përdorura në vlerësimin e rrezikut, të sistemeve dhe të cilësisë së të dhënave të përfshira në llogaritje. Në këtë kuadër, do të vlerësohet jo vetëm respektimi i mjaftueshmërisë së kapitalit nga ana e bankës, por edhe aftësia e saj për të parashikuar dhe për të vlerësuar nevojat e veta për kapital shtesë, të cilat burojnë nga profili i saj i rrezikut.

Ky element është një sfidë e vërtetë në funksionin mbikëqyrës, pasi kërkon ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore dhe financiare, me qëllim që të realizohet në mënyrë të pranueshme niveli i përshatshëm i rrezikut të bankave dhe të kryhen ndërhyrjet e nevojshme për të rritur nivelin e kapitalit në përputhje me profilin e rrezikut të rivlerësuar.

Shtylla 3: Disiplina e tregut.

Publiku dhe tregu do të luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave. Në këtë shtyllë, përcaktohen kërkesat për një transparencë më të madhe të elementeve kryesore të rrezikut dhe të administrimit të tij në banka, të cilat do të përfaqësonin një informacion të rëndësishëm për investorët dhe për konkurrentët. Kjo do të jepte një pamje të plotë të profilit të rrezikut të bankës dhe do të rriste presionin mbi të, për të administruar rreziqet e saj në mënyrë të kujdesshme. Në një nivel më të përgjithshëm, ky zhvillim do të rriste disiplinën në treg dhe do të kontribuonte në forcimin e stabilitetit financiar në përgjithësi.

Sipas kësaj shtylle, lloji i informacionit që duhet të publikohet duhet të plotësojë disa kushte ku më kryesoret janë:

Informacioni duhet të jetë material, që sipas përcaktimit të IAS (*International Accounting Standards*) do të thotë që, një përjashtim ose keqinterpretim i këtij informacioni mund të ndryshojë

ose të influencojë vlerësimin ose vendimmarrjen e përdoruesit publik të tij. Në lidhje me këtë çështje, për shkak të vështirësisë, Komiteti i Bazelit nuk ka dhënë përkufizime apo kufij specifikë për klasifikimin e informacionit që do të publikohet si material, duke besuar se do të jetë “investitori i arsyeshëm ai që do të përcaktojë informacionin e nevojshëm dhe që do të imponojë nivelin e mjaftueshëm të transparencës”.

Informacioni nuk duhet të jetë konfidencial, pasi në një rast të tillë publikimi mund të dëmtojë pozicionin konkurrues të bankës si dhe marrëdhëniet e saj me klientët.

Sipas kësaj shtylle, ofrohen disa mënyra të përzgjedhjes së informacionit që publikohet në varësi të destinacionit të tij, të gjykimit të administratorëve, të vetë llojit të informacionit si edhe të kërkesave të ndryshme të standardeve ndërkombëtare, ku më të rëndësishme janë ato të IAS.

Gjithashtu, kjo shtyllë orienton edhe mbi frekuencën e raportimit në publik, e cila varion sipas llojit të informacionit. Përfundimisht, bankat duhet të kenë politikat e tyre zyrtare dhe të miratuara në lidhje me publikimin e informacionit dhe me transparencën në publik, duke përfshirë edhe frekuencën e publikimit.

Kërkesat e Akordit të ri të Bazelit, pritët të përfshihen dhe të miratohen në formën e një Direktive Evropiane, deri në mes të vitit 2005. Nëse kjo realizohet, kërkesat e tij do të bëhen të detyrueshme për të gjitha bankat me seli qendrore në Bashkimin Evropian, me fillimin e vitit 2008.

Në rastin e vendit tonë, zbatimi i kërkesave të Akordit të ri të Bazelit, mund të rezultojë më i afërt se ç'mund të mendohet aktualisht. Ai mund të imponohet nga prania e konsiderueshme në sistemin bankar shqiptar e investimeve të kapitalit të huaj me origjinë nga Bashkimi Evropian. Në këto kushte, është e nevojshme njohja e kërkesave të tij nga të gjitha bankat që operojnë në vend, si edhe nga të gjitha institucionet e tjera financiare që ndërveprojnë me sistemin bankar.

Banka e Shqipërisë ka ngritur aktualisht grupin e punës për këtë qëllim, duke synuar të fillojë një proces diskutimi të gjerë me industrinë bankare, për t'u njohur me kërkesat e akordit të ri të Bazelit dhe efektet e tij në sistemin bankar në vend.

6. ANEKSE*

6.1. Aneks I : Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë

6.1.1 Banka dhe degë të bankave të huaja

1. BANKA ITALO – SHQIPTARE SH.A

Licenca Nr. 1/1996, datë 17.07.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 89, datë 18.06.1998.

Çertifikata nr. 1 “Për sigurimin e depozitave”.

Drejtori : Adrian FULLANI

Adresa : Rruga “Barrikadave”, Nr. 70, Tiranë.

Tel. central 23 56 97, 23 56 98, 22 62 62.

Faks 23 30 34.

2. BANKA E KURSIMEVE SH.A

Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.

Çertifikata nr. 2 “Për sigurimin e depozitave”.

Drejtori Steven GRUNERUD

Adresa Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit” Nr.6, Tiranë.

Tel. central 22 45 40, 22 26 69, 22 54 16.

Faks 22 35 87, 22 36 95, 22 40 51.

3. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A

BANKA ARABO-SHQIPTARE ISLAMIKE ka ndryshuar emrin me vendimin nr.4315/7, datë 16.09.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.

Çertifikata nr. 3 “Për sigurimin e depozitave”.

Drejtori Abdul Waheed ALAVI

Adresa Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 8, Tiranë.

Tel. central 22 84 60, 223 873, 227 408.

Faks 228 460, 228 387.

4. BANKA DARDANIA SH.A

Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 01.12.1998.

Çertifikata nr. 4 “Për sigurimin e depozitave”.

Drejtori Beqir MEZELXHIU

Adresa Bulevardi “Zogu I” (pranë Fakultetit të Shkencave), Tiranë.

Tel. central 22 87 59, 25 9350, 25 93 51.

Faks 230-566.

Teleks 2298 db banc ab

Email db@albaniaonline.net; dardaniabank@hotmail.com .

*Të dhënat janë të Korrikut 2004.

5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A

Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.

Çertifikata nr. 5 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa Bulevardi "Zhan Dark" Tiranë.
Tel: 25 09 55.
Faks: 25 09 56.

6. BANKA TIRANA SH.A

Licenca Nr. 07, datë 12.09.1996.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.

Çertifikata nr. 6 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Dimitris KARAVIAS
Adresa Bulevardi "Zogu I", Nr. 55/1, Tiranë.
Tel. central 233 441, 42, 43, 44, 45, 46,47.
Faks 233 417.

7. BANKA KOMBËTARE E GREQISË - DEGA TIRANË

Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 14.03.1996.

Çertifikata nr. 7 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Vasilios FILIS; Spiro BRUMBULLI (drejtor vendor)
Adresa Rruga e "Durrësit", Godina Comfort, Tiranë
Tel. central 233 623, 233 624.
Faks 233 613.

8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A

Licenca Nr. 09, Datë 20.02.1997

LICENCA NR.09, DATË 20.02.1997.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996. Çertifikata nr. 8 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Lee CHONG PA
Adresa Rruga "Ded Gjon Luli", Tiranë.
Tel. central 237 567, 237 568, 237 569.
Telfaks 237 570.

9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA

Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96, datë 27.12.1997.

Çertifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Andrea GALATOULAS
Adresa Bulevardi "Zogu I", Nr.47, Tiranë.
Tel. 233 532, 233 359, 340 476, 340 477.
Telfaks 232 102.

10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË SH.A

Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.

Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.

Çertifikata nr. 10 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Lorenzo RONCARI
Adresa Rruga "Ismail Qemali" Nr.27, P.O. Box 8319 – Tiranë.
Tel. 348 753/4/5/6.
Telfaks 348 762.

11. BANKA PROCREDIT SH.A.

BANKA FEFAD SH.A ka ndryshuar emrin me vendimin nr.20797/10, datë 15.09.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999.

Çertifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Jasper MENKEN

Adresa Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë.

Tel. 230 499, 233 496.

Telfaks 233 481

12. DEGA NË TIRANË E BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SH.A

Licenca Nr. 13, datë 16.04.1999.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë 13.04.1999.

Çertifikata nr. 12 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Petar Gavrillov KRASTEVI

Adresa Bulevardi "Zogu I", Nr. 64, Tiranë.

Tel. 356 423, 356 424.

Telfaks 356 422

13. BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A.

Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.

Çertifikata nr. 13 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori George CARACOSTAS

Adresa Rruga "Kavajës", "Tirana Tower", Tiranë.

Tel. 587 55, 56, 57, 58, 59, 60.

Telfaks 587 52

14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.

Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.66, datë 28.08.2002.

Çertifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Kamal Abdel MANEIM

Adresa Rruga Perlat Rexhepi, Al-Kharafi Group Administration Building , Kati 1&2, Tiranë.

Tel. 272 168; 272 162.

Telfaks 272 162.

E-mail creditbkalb@icc-al.org

15. BANKA "CREDINS" SH.A.

Licenca nr. 16, datë 28.03.2003.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 26.03.2003.

Çertifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Artan SANTO

Adresa Rruga "Ismail Qemali" Nr.21 Tiranë.

Tel 222916; 234096.

16. BANKA POPULLORE SHA, TIRANË.

Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.

Miratur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.06, datë 11.02.2004.

Çertifikata nr. 16 "Për sigurimin e depozitave".

Drejtori Edvin LIBOHOVA

Adresa Rruga "Donika Kastriotii" Pall.11/1, Kati I, Tiranë.

Tel 272 788; 272789.

Subjekte jobanka

1. UNIONI FINANCIAR I TIRANËS SH.P.K., (UFT)

Licenca nr. 1, datë 08.12.1999 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- agjente apo këshilltare financiare .

Drejtor : Niko Leka; Edmond Leka.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pall. Shallvareve, sh.2, nr.18 Tiranë.
Tel : 250 653.

2. DINERS CLUB ALBANIA SH.P.K.,

Licenca nr. 2, datë 09.10.2000 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare .

Drejtor : Vebi Velia
Adresa : Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.

3. POSTA SHQIPTARE SH.A.

Licenca nr. 3, datë 18.04.2001 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Pronësia : Shtetërore
Drejtoresha : Aleksandra Çollaku
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku" , nr.4 Tiranë.
Tel : 222 315.

4. "CREDINS" SH.A. TIRANË.

Licenca nr. 04, datë 13.06.2001 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të dhënies kredi;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26 të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").

Drejtoresha : Monika Milo
Adresa : Rruga "Ismail Qemali" Nr.21, Tiranë.
Tel : 222916; 234096.

5. "FONDI I FINANCIMIT TË ZONAVE MALORE".

Licenca nr. 5, datë 29. 03.2002 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtarinë e mëposhtme:

- të japë kredi.

Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Drejtori: Arben Jorgji
Adresa: Rruga "Mustafa Matohiti", Vila nr.12, Tiranë.
Tel.: 250633.

6. "ALBAKREDIT SH.P.K"

Licenca nr. 6, datë 18. 04.2003 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtaritë e mëposhtme

- të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat).

Administratori: Ermira Skënderi
Adresa : Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.5 Tiranë.
Tel.: 230 956.
Faks: 228 929.

7. "AK - INVEST SH.A"

Licenca nr. 7, datë 03.12.2003 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtaritë e mëposhtme

- të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të shërbejë si agjent dhe këshilltar financiar.

Administratori: Ilir Adili
Adresa : Rruga "Ded Gjon Luli", nr.2/3 Tiranë.
Tel.: 240 147

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: “Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë””.

(Këto subjekte nuk licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.)

1. Fondi i Financimit Rural.
 - Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
 - Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
 - Selia: Rruga “Ismail Qemali”, P. 32, Tiranë.
 - Drejtor: Zana Konini.
 - Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 1843, datë 01.08.2000.

2. Fondacioni Besa.
 - Themeluar nga “Fondi i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë” (SOROS).
 - Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
 - Selia: Rruga “Asim Vokshi”, Nr. 35, Tiranë.
 - Drejtor: Bajram Muça
 - Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/I, datë 19.01.2001.

3. Partneri Shqiptar për Mikrokredinë.
 - Aksioner: “Opportunity International”(East Europe).
 - Objekti i veprimtarisë: Kredidhënia.
 - Adresa: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Nr. 7/I, Tiranë.
 - Drejtor: James Reiff.
 - Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 828/I, datë 08.04.2002.

Zyra të këmbimeve valutore

1. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JOARD" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 1, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli" Nr.2, Tiranë.
Kambistë: Josif Kote, Pajtim Kodra.
2. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMA" SH.P.K., Durrës
Licenca: Nr. 2, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës.
Kambistë: Mirlinda Ceka, Ilir Hoxha.
3. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIS" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 3, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Luigj Gurakuqi", Tiranë.
Kambistë: Ardian Goci, Ismet Noka.
4. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SH.P.K.,
Licenca: Nr. 4, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pall. Shallvare, Shk. 2/18, Tiranë.
Administrator : Niko Leka-
Kambistë: 1. Arjan Lezha Përgjegjës i agjencisë
2. Albert Sara
3. Dhimitër Papadhopulli
4. Genta Angjeli (Agalliu)
5. Piro Teti
6. Flora Simitxhi
7. Petrika Mano Përgjegjës i agjencisë
8. Lindita Shala
9. Mirela Bakalli
10. Anila Demiri
11. Emili Bakalli (Nako)
12. Astrit Sferdelli
13. Mirela Kaiku
14. Erisa Emiri
5. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AGLI" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 5, datë 01.10.1999.
Adresa: Agjencia 1: Rruga "Islam Alla" Nr.1, Tiranë.
Agjencia 2: Rruga "Kavajës", pranë pastiçeri "Rinia", Tiranë.
Kambiste: Agim Cani, Kujtim Nina (Drejtor i Shoqërisë.), Selim Luli.
6. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBAKREDIT" SH.P.K., TIRANË
Licenca: Nr. 06, datë 24.11.1999.
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli" Nr.5, Tiranë.
Kambistë: Ëngjëll Skënderi
Arben Cani
Vasil Marto
Hajredin Toça
Dallëndyshe Shima
Ermira Skënderi
Valbona Kurti
Teuta Koltraka

7. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 08, datë 24.11.1999.
 Adresa: Rruga "Durrësit" Nr. 170, Tiranë.
 Kambistë: Ivan Pavilovski, Ervis Myftari
9. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNISIX" SH.P.K., KORÇË
 Licenca: Nr. 09, datë 26.11.1999.
 Adresa: Bulevardi "Republika", Pall.4, Korçë.
 Kambistë: Pandi Cunoti, Ernest Golka, Nikolin Bicka, Eli Bode.
9. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EKSPRES J & E" SH.P.K., DURRËS
 Licenca: Nr. 10, datë 26.11.1999.
 Adresa: Lagja 11, Rruga "Prokop Meksi" (pranë hotel "Durrësi"), Durrës.
 Kambistë: Kostandin Ekonomi, Entela Ekonomi.
10. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MI & CO" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 11, datë 29.02.2000.
 Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë.
 Kambistë: Muharrem Kokona, Ilir Adili, Andis Tirana.
11. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ILIRIA '98" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 12, datë 25.02.2000.
 Adresa: Sheshi "Skënderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë.
 Kambistë: Edmond Ymeri, Ali Topalli, Ilir Janku.
12. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SERXHIO" SH.P.K., ELBASAN
 Licenca: Nr. 14, datë 07.04.2000.
 Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nëntori", Pall. 70, Nr.14, Elbasan.
 Kambistë: Amarildo Canku
13. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBTUR" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 15, datë 07.04.2000.
 Adresa: Bulevardi "Zogu I", Pall. 32, Shk.1 (përballë Bankës Tirana), Tiranë.
 Kambistë: Albert Rahmani, Artur Rahmani.
14. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & M" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 16, datë 22.05.2000.
 Adresa: Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pall.182, Tiranë.
 Kambistë: Edmond Stepa, Miranda Stepa.
15. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TEUTA 2000" SH.P.K., DURRËS
 Licenca: Nr. 17, datë 22.05.2000.
 Adresa: Lagja 4, Rruga "Skënderbej", Ap. 950, Durrës.
 Kambistë: Adelina Hoxha, Arben Çuni.
16. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "T & E" SH.P.K., DURRËS
 Licenca: Nr. 18, datë 11.06.2000.
 Adresa: Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës.
 Kambist: Shpëtim Hysa
17. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SHIJAK 2000" SH.P.K., SHIJAK
 Licenca: Nr. 19, datë 24.11.2000.
 Adresa: Lagja "Popullore", Shijak.
 Kambist: Nazmi Ademi, Farije Ademi
 Tel. 05713076; 05712193.

19. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & T" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 20, datë 20.12.2000.
 Adresa: Bulevardi "Zogu I", (pranë BPI-së), Tiranë.
 Kambist: Renis Tershana
19. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DV-ALBA" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 21, datë 11.01.2001.
 Adresa: Sheshi "Skënderbej", Tirana Internacional Hotel, Tiranë.
 Kambist: Brunilda Haxhimali.
20. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MANUSHI" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 22, datë 18.04.2001.
 Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.
 Kambist: Roland Manushi
21. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI SELVIA" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 23, datë 21.05.2001.
 Adresa: në krah të Postës Qendrore, godina 2-katëshe, kati I, Tiranë.
 Kambist: Leonat Zenelaj, Gani Xhaja.
22. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KALENJA" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 24, datë 29.06.2001.
 Adresa: Rruga "Kavajës" (pranë Ambasadës Turke), Tiranë.
 Kambist: Hair Shametaj, Fatmir Shametaj, Gëzim Dushkaj
23. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TILBA" SH.P.K., ELBASAN
 Licenca: Nr. 25, datë 30.09.2001.
 Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan.
 Kambist: Kristaq Bako, Vjollca Bako.
24. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ANAGNOSTI" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 26, datë 31.10.2001.
 Adresa: Zyra 1- Bulevardi "Zogu I", Pallati 97, shk.3.ap. 28, Tiranë.
 Kambist: Jani Anagnosti, Odise Anagnosti, Edlira Anagnosti
 Zyra e dytë, Rruga "Kajo Karafili", nr.11 Tiranë.
 Rruga "Kajo Karafili", nr.11 Tiranë
 Kambist: Fredi Cami.
25. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KO-GO" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 27, datë 12.11.2001.
 Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Pall.16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë.
 Kambist: Mihal Konomi, Përparim Goxhaj.
26. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- FOREX" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 28, datë 22.11.2001.
 Adresa: Agjencia 1- Rruga "Abdyl Frashëri Nr.3, Tiranë.
 Agjencia 2- Rruga "Mine Peza", Pall. 102, Shk.1 (pranë Bar Grand), Tiranë.
 Kambist: Almir Duli; Agim Xhemo; Fatmir Baholli.
27. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "L&N" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 29, datë 22.11.2001.
 Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", ish-Gjelltorja tek sheshi ATATURK, Tiranë.
 Kambist: Leonora Mihalcka.

28. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE ALOG" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 31, datë 22.11.2001.
 Adresa: Rruga "Mine Peza" (përballë selisë së Vatikanit), Tiranë.
 Kambist: Almida Sterio, Fatmir Tafaj, Eduard Andoni.
29. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EX-CHANGE BEBI & FLORI" SH.P.K., FIER
 Licenca: Nr. 32, datë 26.11.2001.
 Adresa: Lagja "Kongresi i Përmetit", Fier.
 Kambist: Kujtim Zeneli, Fatmir Brahimi.
30. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BASHKIMI 2001" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 35, datë 12.12.2001.
 Adresa: Rruga e "Kavajës" (pasiçeri "Rinia"), Tiranë.
 Kambist: Bashkim Shametaj, Luan Shametaj dhe Ilir Mesini.
31. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARJON 2002" SH.P.K., ELBASAN
 Licenca: Nr. 36, datë 14.12.2001.
 Adresa: Lagja "Kongresi i Elbasanit", Bulevardi "Qemal Stafa", Pall.9-katësh, Elbasan.
 Kambist: Arben Kovaçi, Besnik Lulja.
32. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALAKTH" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 42, datë 18.01.2002.
 Adresa: Rruga e "Dibrës", nr.105/1, Tiranë.
 Kambist: Kosta Papa, Arben Memko, Lorenc Konomi, Thoma Konomi, Aleko Plaku.
33. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "FORMAT" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 43, datë 21.01.2002.
 Adresa: Rruga e "Durrësit", Pall.85, shk.1,ap.1, Tiranë.
 Kambist: Diana Lemi, Egon Sinani;
34. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TRI URAT" SH.P.K., ELBASAN
 Licenca: Nr. 44, datë 05.02.2002.
 Adresa: Lagja "29 nëntori", pranë filialit të postës Elbasan.
 Kambist: Fahri Sanco, Ismail Bejta.
35. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BESA 2001" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 46, datë 15.02.2002.
 Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Nr.25,Tiranë.
 Kambist: Belul Lleshi, Vladimir Avda, Mimoza Avda.
36. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MARIO" SH.P.K., SARANDË
 Licenca: Nr. 47, datë 14.03.2002.
 Adresa: Lagja 1, pranë ish-Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
 Kambist: Vangjel Gramozi, Blerim Dhima.
37. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JAV" SHPK TIRANË, KA NDRYSHUAR EMRIN ZYRA E KËMBIMIT VALUTOR "R&T EXCHANGE" SH.P.K.
 Licenca: Nr. 48, datë 20. 03.2002.
 Adresa: Bulevardi "Zogu I" Godina e Zërit të Popullit Tiranë.
 Kambist: Ervin Lera, Ilir Gurashi.
38. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DROGU" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 49, datë 23.04.2002.
 Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Kulla 1, Kati I (pas pallatit Agimi) Tiranë.
 Kambist: Shkëlqim Drogu, Kostandin Koteci.

39. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "HYSEN-C" SH.P.K., LAÇ
 Licenca: Nr. 50, datë 23.04.2002.
 Adresa: Lagja nr.3, përballë Komisarariatit të Policisë, Laç.
 Kambist: Cen Hyseni;
 Tel.: 0682024688.
40. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FIER" SH.P.K., FIER
 Licenca: Nr. 51, datë 08.05.2002.
 Adresa: Lagja "15 Tetori", Rruga "Kastriot Muça", Fier.
 Kambist: Gjergj Dulaj; Lartim Isufaj.
41. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TAXI EKSPRES" SH.P.K., ELBASAN
 Licenca: Nr. 52, datë 20.05.2002.
 Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.11 (pranë Shkollës "Edit Durhan").
 Kambist: Arben Sharra, Sokol Kaleci.
42. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MERO" SH.P.K., DEVOLL
 Licenca: Nr. 53, datë 22.05.2002.
 Adresa: Zyra nr.1 : Bulevardi "Fuat Babani", Bilisht.
 Zyra nr.2 : Dogana Kapshticë.
 Kambist: Gëzim Demcolli, Valter Miza, Genti Mahmutaj, Albert Haxhia, Edmond Miza.
43. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "GLEAR" SH.P.K., SHIJAK
 Licenca: Nr. 55, datë 23.07.2002.
 Adresa: Lagja "Kodër", Shijak, Durrës.
 Kambist: Argjend Calliku, Afërdita Calliku.
44. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "POSTA SHQIPTARE" SH.A. TIRANË
 Licenca: Nr. 56, datë 28.08.2002.
 Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", nr.4 Tiranë.
45. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI BALLSH" SH.P.K., BALLSH
 Licenca: Nr. 57, datë 11.09.2002.
 Adresa: Rruga "8 Nëntori", Ballsh.
 Kambist: Luan Zenelaj, Lavdimir Zenelaj
46. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ESLULI" SH.P.K., TIRANË
 Licenca: Nr. 58, datë 17.10.2002.
 Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pallati i Shallvareve, shkalla n.4/1.
 Kambist: Selim Luli, Kleomen Gjikhuri
47. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE ""AMERICAN GLOBAL CAPITAL FUND-WORLDWIDE INVESTMENT" SH.P.K. TIRANË
 Licenca: Nr. 59, datë 26 .11.2002
 Përfaqësues
 me prokurë : Dashor Shehaj, Vilson Ahmeti.
 Adresa: Rr. "Ismail Qemali", Parcela 167/187 "Euroapartment", Tiranë
 Kambist: Elda Skënderi, Vasil Llogoro, Arian Kokali.
48. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DENI&KRISTI-2002" SH.P.K. TIRANË
 Licenca: Nr. 61, datë 02.06.2003
 Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 60, ap.3, Tiranë.
 Kambist: Maksim Çeku.

49. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "YLDON" SH.P.K. TIRANË
 Licenca: Nr. 62, datë 03. 06.2003.
 Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Pallati 382/2/2 Tiranë.
 Kambist: Ylli Ndoqi(themelues dhe administrator).
50. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BILLI" SH.P.K. TIRANË
 Licenca: Nr. 63, datë 16. 02.2004.
 Adresa: Sheshi "Wilson" Pallati i ri në kryqëzimin e Tiranës së re.
 Kambist: Sybi Cenolli.
51. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "REXHA F&E" SH.P.K. DURRËS
 Licenca nr. 64, datë 07.04.2004
 Adresa: Rruga "Mujo Ulqinaku", Lagja nr. 5, Pallati 619, Durrës.
 Kambist: Fatmir Rexha (themelues dhe administrator)
 Ermira Rexha
52. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBA&ARBËR" SH.P.K., TIRANË
 Licenca nr. 65, datë 06.05.2004
 Adresa: Rruga "Kavajës", pall. 3, kati i parë, Tiranë.
 Kambistë: Pëllumb Memetaj dhe Bukurosh Jaho (të dy janë edhe administratorë)
53. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "I.S.N." SH.P.K., TIRANË
 Licenca nr. 66, datë 06.05.2004
 Adresa: Rruga "Kavajës", pall. 3, kati i parë, Tiranë.
 Kambistë: Evzi Zemzadja, Nexhmi Uka dhe Salandi Brojaj
 Nr. mobile: 068 20 35 265 Evzi Zemzadja (administrator)
 069 20 32 727 Salandi Brojaj
54. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIABA" SH.P.K., TIRANË
 Licenca nr. 67, datë 07.06.2004
 Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", kati i parë, shkalla 5, pranë Librit Universitar, Tiranë.
 Kambistë: Agim Xhemo dhe Astrit Hado (Agim Xhemo administrator)
55. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBACREDITS" SH.P.K., TIRANË
 Licenca nr. 68, datë 13.07.2004
 Adresa: Rruga "Murat Toptani", pallati 12 katesh, kati perdhe, Tiranë.
56. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- KREDIT" SH.P.K., TIRANË
 Licenca nr. 69, datë 19.07.2004
 Adresa: Rruga "Kongresi i Përmetit", nr.2, (në Rrugën e Durrësit) Tiranë.

Unionet e shoqërive të kursim-kreditit

1. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "JEHONA" TIRANË

Licenca: Nr.1, datë 27.06.2002.

Kryetar i bordit drejtues : Vojsava Rama

Anëtare të këtij unioni janë 41 shoqëri të kursim-kredive, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga fondacioni "Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kredive".

2. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "UNIONI SHQIPTAR KURSIM-KREDITIT" TIRANË

Licenca: Nr.2, datë 09.08.2002.

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", nr.32.

Kryetar i bordit drejtues : Zana Konini

Tel. 25 19 10

E-mail : ffrural@albaniaonline.net

Anëtare të këtij unioni janë 98 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondi i Financimit Rural.

Zyra të përfaqësimit të bankave të huajazyra të përfaqësimit të bankave të huaja

I. Zyrës së Përfaqësimit të Bankës Popullore Pulieze në Shqipëri.

Licenca: Nr.1 datë, 02.07.2003.

Përfaqësuesi: Dr. Giancarlo STASI

Adresa: Sheshi "Skënderbej" - pranë Pallatit të Kulturës - kati i tretë

Nr.telefonit: 00 355 4 256 782

Aneks 2: Lista e rregulloreve të mbikëqyrjes bankare në fuqi, deri në muajin korrik 2004

- 1- Rregullorja “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 71, datë 11.09.2002.
- 2- Rregullorja “Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 120, datë 30.12.2003.
- 3- Rregullorja “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 96, datë 26.11.2003.
- 4- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12 datë 21.02.2001, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 08.05.2002.
- 5- Rregullorja “Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal, për veprimtaritë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 22.04.1999.
- 6- Udhëzimi “Për kapitalin rregullator”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 24.03.2004.
- 7- Rregullorja “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.82, datë 08.10.2003, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 24.03.04.
- 8- Rregullorja “Për pozicionet e hapura valutore”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 118, datë 01.12.1999.
- 9- Rregullorja “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 64, datë 30.07.2003, ndryshuar me vendimin nr.101, datë 10.12.2003.
- 10- Udhëzimi “Për likuiditetin e bankave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 19.01.2000, ndryshuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2003.
- 11- Rregullorja “Për rreziqet e tregut”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 02.06.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 98, datë 19.12.2001.
- 12- Rregullorja “Për kontrollin e rreziqeve të mëdha”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 07.07.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 119, datë 01.12.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.92, datë 05.12.2001.
- 13- Udhëzimi “Për kontrollin e brendshëm në banka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 107, datë 03.11.1999.
- 14- Rregullorja “Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.42, datë 06.06.2001.
- 15- Rregullorja “Për bankat kooperativë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 29.03.2000.

16- Udhëzimi “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.61, datë 05.07.2000.

17- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 29.03.2000 “Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë””.

18- Rregullorja “Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 60, datë 05.07.2000.

19- Rregullore “Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.06, datë 29.01.2003, ndryshuar me vendimin nr.102, datë 10.12.2003.

20- Sistemi i raportimit të shoqërive të kursim-kredive, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 05.09.2001.

21- Udhëzimi “Për çertifikatat e depozitave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 03.10.2001.

22- Rregullore “Për parandalimin e pastrimit të parave” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.10, datë 25.02.2004.

23- Rregullorja “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.2002, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 12.02.2003.

24- Udhëzimi “Për kujdestarinë dhe likuidimin e bankave” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.45, datë 12.06.2002.

25- Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 58, datë 24.07.2002 miraton shtimin në veprimtaritë e lejuara të bankave të “veprimtarisë bankare lidhur me arin dhe metalet e çmuara”.

26- Rregullorja “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 28.08.2002, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 83, datë 13.11.2002.

27- Rregullorja “Për licencimin e zyrave të këmbimit valutor” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 30.07.2003.

28- Udhëzimi “Për raportimin e veprimeve të këmbimeve valutore” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 30.07.2003.

29- Rregullorja “Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 100, datë 10.12.2003.

